



RAPORT
(Auditimi Financiar)

Tiranë, Korrik 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 - 7
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II.	HYRJA	7 - 12
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	12 – 71
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12 – 14
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	14 – 71
2.1	<i>Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin e brendshëm.</i>	14 – 19
2.2	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	19 – 26
2.2.5	<i>Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi tyre</i>	26 – 31
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	31 – 41
2.4	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave)të transferuara sipas VKM..</i>	41 – 48
2.5	<i>Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.</i>	48 – 71
IV	GJETJE DHE REKOMANDIME	71 – 80
V	ANEKSE	80 - 117

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Peqin, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Peqin për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin 2022 të datës 28.02.2023, të publikuar në faqen zyrtare Buxheti i Bashkisë Peqin si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Peqin si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Peqin. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM
- mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi

i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 19 gjetje dhe ka dhënë 19 rekomandime, nga ku masa organizative me 16 gjetje dhe 16 rekomandime, 2 gjetje-rekomandime të ardhura të munguara në vlerën **6,689,346 lekë** dhe 1 (një) gjetje-rekomandim për masat që duhet të merren në uljen e borxhit tatimor në vlerën **36,951,278 lekë**.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

- Debitorë në vlerën 230 subjekte në vlerën 14,372,078 lekë nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit.

- Debitorë familjarë 5688 familje në vlerën 22,579,200 lekë nga mos arkëtimi i taksës së tokës, taksë ndërtese dhe tarifa vendore.

- Të ardhura të munguara në vlerën 6,151,138 lekë nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për leje legalizimi nga 132 persona.

- Të ardhura të munguara në vlerën 538,208 lekë nga mos arkëtimi i detyrimeve për 6 kontrata shfrytëzimi të sipërfaqeve pyjore.

-Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e asetëve

Nga auditimi rezultoi se, janë 246 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Peqin (Qendër) me VKM. Nga këto prona janë hipotekuar 14 prona.

Për katër ish-komuna, Gjocaj, Përparim, Pajovë, Shezë nuk ka Vendim të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës përfundimtare të pronave. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Peqin nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Në zbatimin e buxhetit:

Kryetari i Bashkisë të marrë masat për rritjen e të ardhurave, duke u ndjekur periodikisht nga personat përgjegjës me qëllim që Këshilli Bashkiak të jetë në gjendje të kontrollojë dhe monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës financiare të Bashkisë. Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Në hartimin e pasqyrave financiare:

- Drejtoria e Financës të marrë masa të kryej inventarin fizik për llogaritë e Aktiveve Afatgjata Materiale në fund të periudhës me qëllim krahasimin e gjendjes kontabël me gjendjen fizike dhe për diferencat e konstatuara të bëjë sistemimet në kontabilitet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesat e konstatuara.

Drejtoria e Financës, Bashkia Peqin, të kontabilizojë vlerën prej 6,151,138 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për saktësimin dhe arkëtimin e debitorëve, në vlerën 37,981,888 lekë.

- Kryetari i Bashkisë Peqin, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” sh.a për 36 artikujve, pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 589,691,927 lekë.

- Drejtoria e Financës, të bëjë sistemimet në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, duke zbritur vlerën prej 37,981,888 lekë, që i përkasin debitorëve për taksa e tarifa vendore.

Në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore:

- Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHKT Bashkia Peqin, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e taksës së llogaritur, si dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për **132 persona me vlerë 6,151,138 lekë**, sipas pasqyrës Aneks 2/4 bashkëlidhur RPA.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, bashkia Peqin, të marrë të gjitha msat për bllokimin e aktivitet të subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregti karburanti pa u paisur me autorizim/licensë ushtrim aktivitet, për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit prej **6,000,000 lekë nda 6 subjekteve**.

Bashkia Peqin, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën **36,951,278 lekë**.

- Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin Juridik të lidhjes së kontratave të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimit **prej 538,208 lekë ndaje 6 subjekteve**. Në rast mos likuidimi sipas afatave të vijojnë me procedurat për zgjidhjen e kontratave përkatëse për dhënien në përdorim të fondit pyjore/kullosor.

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH^{së}, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Peqin për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimit shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Peqin janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinion e modifikuar, me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA^{të}). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Peqin, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 16,475 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

- Llogaritë e Aktiveve Afatgjata Materiale, 210 “Toka troje terrene”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik.

- Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është nënvlerësuar për vlerën 6,151,138 lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit.

- Llogaria 202 “*Studime dhe projekte*”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, nuk është pakësuar për vlerën e 36 artikujve për ujësjellës e kanalizime në shumën 589,691,927 lekë që i përkasin inventarit të Ujësjellës Kanalizime Peqin.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 491/1 prot., datë 15.04.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.04.2024 deri në datë 10.05.2024, në subjektin Bashkia Peqin, për periudhën nga 01.01.2023 deri me 31.12.2023, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar*” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. P.G, *përgjegjës grupi*
2. R.A, *auditues,*
3. E.S, *auditues,*
4. E.G *auditues.*

1.OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Peqin kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;

-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Qëllimi i auditimit.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Peqin, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Identifikimi i çështjes.

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Peqin, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

-Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.

-Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

-Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.

-Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave)të transferuara sipas VKM.

- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Peqin, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Peqin, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Peqin është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Peqin. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- ✓ Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- ✓ VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor”
- ✓ V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- ✓ V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies

me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar

- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;

✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”;

✓ Udhëzimi MF nr. 21, datë 25.10.2016 “*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*”;

✓ Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*”;

- Udhëzimin e MF nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*”;

- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;

✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar;

-Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*”;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, dt. 16.10.2017.

- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “*Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike*”

▪ *Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;*

▪ *Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;*

▪ *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*

▪ *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*

▪ *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Peqin grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

✓ ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”;

✓ ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

✓ ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200;

✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe

- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit

të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

- Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Peqin me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Raporti Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Peqin, pasi nga grupi i auditimit janë reflektuar observacionet e ardhura në fazën e akt konstatimeve të cilat kanë ardhur me vonësë me shkresën nr. 940, datë 17.05.2024 (*prot KLSH nr. 491/2, datë 21.05.2024*) si dhe nga subjekti i audituar me shkresën nr. 1249, datë 25.06.2024 (*prot KLSH nr. 491/4, datë 27.06.2024*), është kthyer Projekt Raporti i Auditimit me observacione, i cili është dërguar në subjekt me shkresën nr. 491/3, datë 27.05.2024.

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Bashkia Peqin kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Elbasan, në jug-lindje me bashkinë Cërrik, në jug-perëndim me bashkinë Lushnje dhe në jug me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Peqinit.

Sipas Censurit të vitit 2011, Peqini ka një popullsi prej 26.136 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 38.900 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 197.79 km² me një densitet prej 196.67 banorë/km² sipas regjistrimit civil dhe 132 banorë/km² sipas censurit.

Bashkia e re e Peqinit shtrihet përgjatë rrugës së vjetër Egnatia, ndërsa kalaja Klaudiana në qendër të qytetit është dëshmi e lashtësisë së këtij vendbanimi. Qyteti dhe të 50 fshatrat e kësaj bashkie shtrihen në një zonë fushore dhe kodrinore. Banorët e bashkisë së Peqinit janë të orientuar ndaj bujqësisë dhe vreshtarisë, por edhe mbarështimit të shpendëve. Kultivimi i ullinjve, i perimeve të serave dhe i produkteve të tjera bujqësore janë gjithashtu karakteristikë e zonës. Peqini është i njohur për rritjen e gjelit të detit, mjaft i kërkuar në të gjithë Shqipërinë në kohë festash si dhe për sportin e ndeshjeve me gjela. Bizneset janë kryesisht të përqendruar në shërbime, ndërkohë që në Peqin janë ngritur edhe disa punishte për vajin e ullirit. Problemi më i madh i Peqinit është punësimi. Edhe pse një pjesë e mirë e banorëve merren me bujqësi, mundësitë ekonomike për ta janë të pakta. Sfidat e bashkisë së re janë të harmonizojë zonën urbane me zonën rurale si dhe hapja e bizneseve prodhuese, që mund t'i jepnin një hov punësimit të banorëve të Peqinit.

Misioni i Bashkisë Peqin është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Peqin, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Peqin për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më

transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Peqin, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin.

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1: “*Angazhimi për integritet dhe vlerat etike*”.

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, nëpërmjet të cilit sigurohet vendosja e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike. Në lidhje me këtë komponent rezultojnë se:

- Me vendimin nr.16 datë 08.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Peqin.

-Me Vendimin nr.16 /1 datë 08.01.2021 është miratuar Kodi i Etikës, ku ndër të tjera përcaktohen parimet bazë për shmangien e konfliktit të interesit dhe të ndalimit të shpërdorimit të detyrës.

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Marrëdhëniet e punës vlerësohen në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore edhe për punonjësit, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kod Pune;

Në lidhje me parimin 2: “*Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje*”.

- Për vitin 2023 është konstatuar se nuk ka plan-veprimi për MFK ku të përfshihen aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit dhe strukturat përgjegjëse për përmbushjen e tyre.

Në lidhje me parimin 3 “*Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë*”.

Me vendimin nr.63 datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak është miratuar struktura dhe niveli i pagave për vitin 2023 me 341 punonjës, përfshirë aparatit administrativ të bashkisë dhe institucionet në varësi. Struktura Organizative e Bashkisë Peqin, e ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi ka pasur disa ndryshime. Konkretisht me vendimin nr.38 datë 28.07.2023 është bërë shkurtimi i 39 pozicioneve pune.

Në lidhje me parimin 4: “*Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave*”.

- Në Bashkinë Peqin, për vitin 2023, është miratuar programi vjetor i trajnimeve, konkretisht përmes institucionit trajnues ASPA.

- **Në lidhje me parimin 5:** “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS):

Me Vendimin nr.380 datë 22.05.2023 në Bashkinë Peqin është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik ku Kryetar i GMS është Kryetari i Bashkisë dhe janë përfshirë të gjithë nivelet drejtuese.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij;

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësive publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij komponenti, titullari i njësive publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsisë, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsisë.

Në lidhje me parimin 6: “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”.

- Nga Bashkia Peqin përcaktohen objektiva sasiore (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Peqin nuk ka plane operacionale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Peqin, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

- Në Bashkinë Peqin është hartuar regjistri i riskut për vitin 2023 por nuk ka një koordinator të deleguar të riskut;

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Për periudhën objekt auditimi, me shkresën nr. 88 datë 18.01.2023 është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut për vitin 2023.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim”.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarive mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

- Bashkia Peqin në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni apo nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për t’i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke mos përcaktuar detyrat me personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara. Bashkia Peqin nuk ka një sistem të plotë të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

- Në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.);

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Peqin nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar infrastrukturë IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Në rregulloren e brendshme nuk përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterat e bashkisë;

- Në Bashkinë Peqin nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish;

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listëpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, të cilat më pas kontrollohen.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Bashkia Peqin disponon faqen e saj zyrtare në internet, peqini.gov.al, ku pasqyrohet aktiviteti i bashkisë.

Në lidhje me parimin 14: “Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor”.

-Procedurat për të siguruar që menaxherët dhe personeli i njësisë publike të informohen për vendimet/projektet/nismat e njësive të tjera, që mund të ndikojnë në përgjegjësitë dhe detyrat e tyre përfshijnë komunikime përmes e-maileve dhe mbledhjeve. Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

Në lidhje me parimin 15: “Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”.

- Është konstatuar se në faqen web të Bashkisë Peqin janë paraqitur informacione si buxheti i bashkisë, tarifat dhe taksat vendore por mungon raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2023.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Në Bashkinë Peqin mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH dhe nga njësia e auditit të brendshëm.

- Në Bashkinë Peqin aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe janë pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshëm, efektiviteti i shërbimeve publike i

shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dërguar planin e veprimit për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Pretendimi i subjektit: *Me shkresën nr.491/2 datë 21.05.2024, nga Bashkia Peqin është përcjellë observacioni se me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.38 datë 08.07.2023 është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut për vitin 2023 ndërsa me urdhrin nr.88 datë 18.01.2023 është miratuar “strategjia e menaxhimit të riskut për Bashkinë Peqin”.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni merret në konsideratë.

1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimitarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Peqin;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2023;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

- Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Struktura e auditimit të brendshëm si pjesë përbërëse e strukturës së bashkisë është miratuar me VKB nr.63 prot, date 23.12.2022 dhe është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1572/1 prot, datë 10.01.2023 me përbërje 3 (tre) punonjës, nga të cilët 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) specialiste auditimi. Përgjegjësi i Sektorit z. A.D dhe specialistja audituese zj.M.Sh janë të certifikuar, ndërsa specialisti tjetër auditues z. A.Gj i cili që nga data 01.12.2022 ka zëvendësuar në këtë detyrë z. B.K, është i pa certifikuar. Struktura e njësisë së auditimit të brendshëm për vitin 2023.

Tabela 1. Mbi strukturën e Auditit të Brendshëm

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
	Për vitin 2023					
1	A.D	P/Njësisë	10. 04. 2018	I lartë ekonomik	Po	Po
2	M.SH	Specialiste	01. 02. 2019	I lartë ekonomik	Po	Po
3	A.GJ	Specialiste	21.12.2022	I lartë ekonomik	Jo	Jo

Burimi: Nga të dhënat e Bashkisë Peqin.

- Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2023.

Në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shkresën nr.1616 prot. datë 14.10.2022 është miratuar Plani Strategjik dhe Vjetor 2023-2025, miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe janë dërguar zyrtarisht ne DQH/AB pranë MFE, ku janë programuar për auditim drejtoritë, sektorët, agjencitë dhe ndërmarrjet e varësisë sipas organigramës dhe nivelit të përcaktuar të riskut.

Gjatë vitit 2023, NJAB ka kryer 9 misione auditimi kundrejt 9 misione të programuara duke realizuar në numër 100 % të planit vjetor. Në planin vjetor të vitit 2023 është bërë një ndryshim

ne subjektet e synuara për t'u audituar. Konkretisht është hequr auditimi në Drejtorinë e të Ardhurave Lejeve&Licencave sipas programimit, me arsyetimin se është audituar nga KLSH. Në vend të kësaj drejtorie për t'u audituar, është përfshirë në planin e vitit 2023, Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore &TIK-ut, i cili nuk është audituar nga ana e NjAB përgjatë viteve 2022 dhe 2023. Në mbështetje të pikës 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetor të auditimit të brendshëm” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, ky ndryshim ne planin vjetor dhe strategjik te AB, është arsyetuar me shkrim nga Përgjegjësi i NjAB të Bashkisë dhe është miratuar nga Kryetari i bashkisë. Karta e auditit të brendshëm i është dërguar Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr.1286 datë 10.08.2022.

Tabela 2. Të dhëna mbi numrin e auditimeve dhe llojeve të tyre.

Nr .	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:				Shërbime të kombinuara	Angazhim	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces	
			përputhshmërisë	performancës	financiare	A. Informacionit					
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+ 3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2
1	Auditim në Njësinë Administrative Pajove	1				1				1	
2	Auditim në Njësinë Administrative Përparim	1				1				1	
3	Auditim në Njësinë Administrative Sheze.	1				1				1	
4	Auditim në Sek. Bur. Njerëzore (Drejt. J, BNJ & TIK)	1				1				1	
5	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve te AB.	1	1							1	
6	Auditim ne Sherb. e Mbrojtjes nga Zjarri&Shpëtimit	1	1							1	
7	Auditim ne Njesine Administrative Gjocaj.	1				1				1	
8	Auditim ne Drejtorinë e Mirëqenies &Kujdesit Social.	1	1							1	
9	Auditim mbi detyrimet e prapambetura financiare te Bashkisë Peqin në fund të vitit 2023.	1			1					1	
	Totali	9	3	0	1	0	5	0	0	9	0

Burimi: Bashkia Peqin

Është kërkuar zhdëmtim i plotë për shkeljet financiare ne shumën 67,220 lekë të dokumentuara në raportet përfundimtare, plan veprimet dhe në memorandumet e dërguara menaxhimit të lartë Sipas të dhënave nga Njësia e Auditit të Brendshëm janë rekomanduar masa organizative, ligjore, ç ‘zhdëmtimi, etj., gjithsej 78 rekomandime te ndara në:-

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve te KB;- dhënë 11, pranuar 11, zbatuar 4, ne proces 7 rekomandime
- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor: dhënë 10, pranuar 10, zbatuar 3, në proces zbatimi 7 rek.
- Rekomandime me karakter organizativ:- dhënë 43, pranuar 43, zbatuar 16, ne proces zbatimi 27 rekomandime
- Rekomandime për arkëtim:- dhënë 14, pranuar 14, në proces zbatimi 14 rekomandime.

Nga 78 rekomandime janë pranuar 78, janë zbatuar 23, në proces zbatimi 55 rekomandime. Janë dhëne rekomandime për arkëtimin e detyrimeve nga taksa e tokës bujqësore për vitet 2020-2023 për subjektet debitorë, të cilat nuk janë përfshire ne pasqyrën e zbulimeve. Këto rekomandime janë përfshire dhe për detyrimet për debitor te taksa biznesi, transporti, qira

kullote, tarifa për shërbime zjarrfikëse , etj.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

- *Programimi i PBA 2023-2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2023.*

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025 rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër të Titullarit të Institucionit nr.10, datë 07.01.2022, të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr. 15, datë 25.03.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 451/1 date 13.04.2022.

Projektbuxheti Afatmesëm për vitet 2023-2025 është miratuar përkatësisht me VKB nr. 25, datë 25.06.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 806/1, datë 07.07.2022 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë nr. 1045, datë 23.06.2022 Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 15 (pesëmbëdhjetë) programe buxhetore.

Tabela 1. Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	1110 (Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi)	86,400	21.7%	87,000	21.4%	87,000	21.3%
2	3140 (Çështjet financiare dhe fiskale)	6,100	1.6%	6,100	1.5%	6,100	1.5%
3	3280 (Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile)	19,500	4.8%	19,500	4.8%	19,500	4.7%
4	4220 (Shërbimet bujqësore)	13,730	3.4%	13,730	3.3%	13,730	3.3%
5	4240 (Menaxhimi i infrastures së ujitjes dhe kullimit)	12,565	3.1%	13,565	3.3%	13,565	3.3%
6	4260 (Administrimi i pyjeve dhe kullotave)	6,635	1.6%	6,635	1.6%	6,635	1.6%
7	4520 (Rrjeti rrugor rural)	45,733	11.5%	45,740	11.2%	46,740	11.4%
8	5100 (Menaxhimi i mbetjeve)	68,600	17.1%	68,600	16.9%	68,600	16.8%
9	6140 (Planifikimi urban vendor)	8,500	2.2%	8,500	2.1%	8,500	2.1%
10	6260 (Shërbimet publike vendore)	22,140	5.5%	25,140	6.2%	25,407	6.3%
11	8130 (Sport dhe argëtim)	11,730	2.9%	11,730	2.9%	11,730	2.9%
12	8220 (Trashëgimia kulturore, dhe artistike)	9,500	2.4%	9,500	2.3%	9,500	2.3%
13	9120 (Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor)	60,585	15.2%	60,585	15%	60,585	14.9%
14	9230 (Arsimi i mesëm i përgjithshëm)	7,600	1.9%	7,600	1.9%	7,600	1.9%
15	10430 (Kujdesi social për familjet dhe fëmijët)	15,690	3.9%	15,690	3.9%	15,690	3.9%
16	1810 (Fondi rezervë dhe emergjencë)	4,750	1.2%	4,619	1.1%	6,046	1.4%
	TOTALI	399,759	100%	405,234	100%	406,928	100%

Burimi. Bashkia Peqin

Tabela 2. Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga 600	188,555	47.2%	188,555	46.5%	188,555	46.3%
2	Sig. 601	31,749	7.9%	31,749	7.8%	31,749	7.8%
3	Shpenzime operative 602	125,420	31.4%	125,420	30.9%	125,420	30.8%
4	Shpenzime604	6,000	1.5%	6,000	1.5%	6,000	1.5%
5	Shpenzime606	3,780	0.9%	3,780	0.9%	3,780	0.9%
6	Fondi rezerv/kontigjences 609	4,751	1.2%	5,619	1.5%	6,046	1.5%
7	Investime 230-231	39,504	9.9%	44,111	10.9%	45,378	11.2%
	Total	399,759	100%	405,234	100%	406,928	100%

Burimi. Bashkia Peqin

Tabela 3. Sipas PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë: Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

A	Tëardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	115,600	112,074	104,074
2	Jo tatimore	45,500	45,500	45,500
I	Totali	161,100	157,574	149,574
1	Transferta e pakushtëzuar	234,794	243,796	253,490
2	Transfertë specifike	3,865	3,865	3,865
II	Shuma e transfertave	238,659	247,661	257,355
III	Transferta te pritshme (FZHR e tjera)			
	Totali i burimeve të veta (I+II+III)	399,759	405,235	406,929

Burimi. Bashkia Peqin

Për vitin 2023, buxheti është miratuar me VKB nr. 62, datë 23.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1573/1 prot., datë 10.01.2023 si dhe VKB nr. 5, datë 27.01.2023 “Për miratimi i të ardhurat e trashëguara dhe grandit i trashëguar nga viti 2022”

Tabela 4. Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Peqin, për vitin 2023.

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
	Të ardhurat	442,101	
	Të ardhura te veta	173,167	
	Grandi	256,883	
	Te ardhura te trashëguara 2022	6,021	
	Grandi i trashëguar nga viti 2022	6,030	
	Shpenzimet		442,101
	Paga (600)		203,152
	Sigurime (601)		33,622
	Shpenzime operative (602)		149,837
	Transferta (603+604+605+606+609)		16,150
	Investime (230+231) nga buxheti i bashkisë		39,340
	Totali i buxhetit	442,101	442,101

Burimi. Bashkia Peqin

Ndryshimi në rritje të vlerës buxhetit të vitit 2023 nga plani i buxhetit të vitit 2023 në PBA vjen si pasojë e të ardhurave dhe garantit të trashëguar nga viti 2022, në vlerën 12,051 mijë lekë dhe nga transfertat e pakushtëzuar e cila për vitin 2023 është për shtesë në vlerën 22,089 mijë lekë. Për sa i përket shpenzimeve rezultojnë se për vitin 2023 shpenzimet për paga e sigurime zënë 53 % ose në vlerën 236,774 mijë lekë, shpenzime korrente zënë 33 % ose për vlerën 149,837 mijë lekë, transfertat zënë 4% ose për vlerën 16,150 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 10 % ose në vlerën 39,340 mijë lekë.

Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar me VKB nr. 63, datë 23.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1572/1, datë 10.01.2023, ndërsa numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin e kryetarit të Bashkisë nr. 46, datë 12.01.2023.

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 63, datë 23.12.2022, në zbatim të VKM nr. 625, datë 28.09.2022, “Për grupimin e njëjësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve të administratave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar.

Paketa fiskale për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 64, datë 23.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1575/1, datë 09.01.2023.

Të ardhurat gjithsej për të financuar buxhetin e vitit 2023, janë planifikuar në vlerën 173,167,000 lekë dhe në fakt janë realizuar në vlerën 86,274,404 lekë.

Të analizuar shpenzimet e miratuara në buxhetin e vitit 2023, për **shpenzimet operative (602)** janë planifikuar në vlerën **149,837,003 lekë**, si më poshtë:

- (6020) Blerje kancelerie, pastrimi, elektrike dhe blerje materiale të ndryshme, në vlerën 11,250,000 lekë,
- (6022) Shërbime të ndryshme si: energji, ujë, shërbim telefonik, shërbim postar, shërbim pastrimi, dru zjarri për ngrohjen e shkollave, në vlerën 96,646,261 lekë,
- (6023) Shërbime transporti si: gazoil, pjesë këmbimi dhe siguracion mjeti, në vlerën 7,700,000 lekë
- (6025) Mirëmbajtje godinash, mirëmbajtje kanale kulluese dhe vaditëse, shërbime për mirëmbajtje të rrugëve, mirëmbajtje të shesheve dhe lulishteve, shërbime mirëmbajtje të ambienteve të shkollave (lyerje), në vlerën 18,630,742 lekë
- (6027) Vendime përmbarimore dhe gjyqësore, në vlerën 7,000,000 lekë,
- (6029) Shpërblime të Këshillit Bashkiak dhe kryepleq të fshatrave, në vlerën 8,600,000 lekë.
- Projekt social për gratë e papuna në vlerën 10,000 lekë

Planifikimi i shpenzimeve kapitale (230+231), në vlerën 39,340,437 lekë, për objektet si më poshtë:

- Objekti “Rikonstruksion i rrugës Ali Ceka”, në vlerën 1,000,000 lekë,
- Objekti “Rikonstruksion i rrugës Demir Gripshi”, në vlerën 13,000,000 lekë,
- Objekti “Studime projektive”, në vlerën 3,000,000 lekë,
- Objekti “Ndërtim i tregut ditor”, në vlerën 4,510,000 lekë,
- Objekti “Blerje pajisje zyre”, në vlerën 500,000 lekë,
- Objekti “Rikonstruksion i rrugës Kodra Ullirit”, në vlerën 3,908,414 lekë,
- Objekti “Rikonstruksion i rrugës Ymer Beheluli”, në vlerën 4,879,000 lekë,
- Shpronësime, në vlerën 500,000 lekë,
- Supervizime dhe kolaudime, në vlerën 1,400,000 lekë,
- Blerje vendosje kamera, në vlerën 500,000 lekë
- Objekti “Rikonstruksion terreneve sportive te shkollës Demir Godelli” në vlerën 143,023 lekë,
- Objekti “Rikonstruksion i shkollës Mustafa Kemal Atatunku” në vlerën 6,000,000 lekë

- *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:*

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, investime, ndihma ekonomike, gjendja civile, grande, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, për vitin 2023 buxheti shtesë gjithsej është në **vlerën 544,079,252 lekë**, e analizuar si më poshtë:

1. Transfertë e kushtëzuar për investime, në vlerën 48,951,420 lekë, për objektet sipas pasqyrës aneks nr. 2/5, bashkëlidhur.
2. Transfertë e kushtëzuar për Ndihmën ekonomike dhe PAK, në vlerën 398,669,000 lekë
3. Transfertë e kushtëzuar për Gjendje Civile, në vlerën 4,688,636 lekë
4. Transfertë e kushtëzuar për emergjenca, në vlerën 8,424,526 lekë
5. Transfertë e kushtëzuar për shërbimet ne zgjedhjet vendore, në vlerën 1,966,200 lekë
6. Transferte e pakushtëzuar për të përballuar rritjen e pagave dhe për detyrime të prapambetura, në vlerën 81,379,470 lekë sipas VKB nr.38, datë 28.07.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 63, datë 23.12.2022 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për vitin 2023”.

- *Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.*

Për zbatimet e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të

gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore.

Tabela 4. Realizimi i treguesve të buxhetit periudha viti 2023 referuar akt akordimeve me thesarin.

Në 000/ lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2023							
		Plani fillim Viti 2023	Çelja në Thesar sipas akt rakordimit	Fakti mesipas akt rakordimit sipas Thesarit	Te ardh veta	Grand	Trans. pakushtez Spec. Funk Deleg	Tran. Kusht.	Tra. Kush Per Inv.
	Paga (600)	203,152	260,112	224,963	38,722	120,454	59,256	6,531	0
	Sigurime (601)	33,622	36,331	34,330	2,475	21,463	9,775	618	0
	Shpenzime (602)	149,837	151,941	98,319	17,268	52,665	28,142	244	0
	(604) F. Re+emer	6,470	7,166	2,947	0	0	0	2,947	0
	Fondi Veçantë (606)	4,380	4,560	2,049	1,129	180	740	0	0
	Fond Ne+Pak (606)	0	398,669	389,603	0	0	0	389,603	
	Inv(230 +231)	39,340	123,602	69,721	4,438	13,101	0		52,182
	Transferta 604	5,300	3,800	1,812	1,812	0	0		
	Totali	442,101	986,181	823,744	65,844	207,862	97,913	399,943	52,182

Burimi. Bashkia Peqin

Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2023, nga 986,181 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 823,744 mijë lekë ose në masën 83 %, sipas burimit të financimit e buxheti në fakt është financuar si më poshtë:

Nga të ardhurat e veta në masën 8% ose në vlerën 65,844 mijë lekë,

Nga grandit në masën 26% ose në vlerën 207,862 mijë lekë,

Nga transfertat e pakushtëzuar specifike në masën 12% ose në vlerën 97,913 mijë lekë,

Nga transfertat e kushtëzuar 48% ose në vlerën 399,943 mijë lekë,

Nga transfertat e deleguar për investime 6% ose në vlerën 52,182 mijë lekë,

Sipas artikujve të shpenzimeve treguesit e buxhetit në tërësi dhe sipas burimeve të financimit janë realizuar si më poshtë:

-Pagat (600) nga 260,112 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 224,963 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura të veta në vlerën 38,722 mijë lekë, grand në vlerën 120,454 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën 59,256 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar në vlerën 6,531 mijë lekë) ose 86%,

-Sigurime shoq. (601) nga 36,331 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 34,330 mijë lekë, me burim financimi (të ardhurat e veta në vlerën 2,475 mijë lekë, grand në vlerën 21,463 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën 9,775 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar në vlerën 618 mijë lekë) ose 94%,

-Shpenzime operative (602) nga 151,941 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 98,319 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura e veta në vlerën 17,268 mijë lekë, grand në vlerën 52,665 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën 28,142 mijë lekë dhe transfertat e pakushtëzuar në vlerën 244 mijë lekë) ose 65%, më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi..

-Shpenzime për ndihma nga transfertat dhe fond rezervë (604-609) nga 414,195 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 396,411 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura e veta në vlerën 2,941 mijë lekë, grand në vlerën 180 mijë lekë dhe transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën

740 mijë lekë dhe transfert e pakushtëzuar funksione të deleguara në vlerën 389,603 mijë lekë ose 96%.

-Shpenzime për investime (230-231) nga 123,602 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 69,721 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura e veta në vlerën 4,438 mijë lekë, grand në vlerën 13,101 mijë lekë dhe transfert e kushtëzuar në vlerën 52,182 mijë lekë,) ose 56%, më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi..

Për sa i përket likuidimit të shpenzimeve operative, sipas urdhër shpenzimeve rezulton se me buxhetin e vitit 2023 janë likuiduar fatura për mallra e shërbimi të vitit 2022, në vlerën 43,408,177 lekë dhe shpenzime të vitit në vlerën 54,911,308 lekë, sipas pasqyrës Aneks 2/1 bashkëlidhur.

Për sa i përket likuidimit të shpenzimeve për investime, sipas urdhër shpenzimeve rezulton se me buxhetin e vitit 2023 janë likuiduar shpenzime për investime të vitit 2022, në vlerën 14,136,021 lekë dhe investime të vitit në vlerën 55,585,394 lekë, sipas pasqyrës Aneks 2/2 bashkëlidhur.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2023, janë dërguar MFE me shkresat nr. 842, datë 29.05.2022 “Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë”, nr. 1755, datë 25.09.2022 “Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin e vitit 2023” dhe shkresa nr. 379, datë 23.02.2023 “Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2023”, brenda afateve ligjore.

Për periudhën objekt auditimi sipas regjistrit të parashikimit janë planifikuar 20 procedura prokurimi për blerje të vogla me fond limit në vlerën në vlerën 14,663,999 lekë dhe në fakt janë realizuar 13 procedura me fond limit në vlerën 7,788,390 lekë dhe janë planifikuar 8 procedura prokurime me vlera të mëdha në vlerën 247,741,814 lekë në fakt janë realizuar 5 procedura në vlerën 183,592,517 lekë, mosrealizimi i tyre vjen si rezultat i mungesës së fondeve kryesisht nga të ardhurat e veta, të dhënat sipas pasqyrës Aneks nr. 2/3 bashkëlidhur.

Konstatimi: Realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me degën e thesarit për vitin 2023, rezultoi se nga 986,181 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 823,744 mijë lekë ose në masën 83 %, Pagat (600) nga 260,112 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 224,963 mijë lekë, ose 86%, Sigurime shoq. (601) nga 36,331 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 34,330 mijë lekë, ose 94%, shpenzimeve operative (602), nga 151,941 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 98,319 mijë lekë, ose 65% dhe shpenzimeve për investime (230-231), nga 123,602 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 69,721 mijë lekë ose 56%, konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative dhe investime, të cilat janë zërat më kryesor të buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se realizimi i tyre është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky mos realizim vjen si rezultat i mos realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore që nga 173,167 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 86,274 mijë lekë ose 50%, veprim jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “Detyrimet e prapambetura” sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

N.R	Emërtimi	Stokun vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)			
a	Hua sfatgjatë			
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër			
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kreditë furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	74,300,773		
a	Shpenzime korrente	43,663,779		
a,1	Mallradhe shërbime	31,614,183		
a,2	Pagadhe sigurime	7,970,846		
a,3	Të tjera	4,078,750		
b	Shpenzime kapitale	11,340,021		
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	11,340,021		
c	Vendime gjyqësore	19,296,973		
c,1	Marrëdhënie pune	3,978,528		
c,2	Mallradhe shërbime			
c,3	Investime	15,318,445		
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	74,300,773	523,480,952	14.2%

Burimi. Bashkia Peqin

Sa më sipër rezulton se totali i detyrimeve të pa likuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 74,301 mijë lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 523,481 mijë lekë zënë 14.2%, kjo e raportuar në MFE me shkresën nr. 286 prot., datë 08.02.2024.

Të analizuara detyrimet e prapambetura të raportuara në MFE paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 2/4, bashkëlidhur.

Nga të dhënat e bilancit rezulton se detyrimi i faturave të pa likuiduara dhe vendime gjyqate në fund të vitit 2023, që i përkasin llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to” janë për vlerën 29,466,810 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” janë për vlerën 64,960,822 lekë, gjithsej në vlerën 94,427,632 lekë sipas të dhënave të pasqyrave si më poshtë:

Diferenca e detyrimeve të pasqyruara në bilanc dhe atyre të raportuara në MFE në vlerën 20,126,859 lekë (94,427,632-74,300,773), janë fatura të cilat i përkasin muajit dhjetor e nuk janë likuiduar për shkak se nuk kanë përmbushur afatin 60 ditorë.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjyqate të raportuara ne MFE në fund të vitit me shkresën nr.286, datë 08.02.2024, janë për vlerën 74,300,773lekë (*shpenzime korrente në vlerën 43,663,779.lekë, shpenzime kapitale në vlerën 11,340,021.lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 19,296,973 lekë*) në raport me shpenzimet e kryera zënë 14,2% të tyre. Të krahasuara me detyrimet e pasqyruara në bilanc në llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” gjithsej në vlerën 94,427,632 lekë rezulton se janë pasqyruar më shumë në bilanc për vlerën 20,126,859 lekë, për faktin se në detyrimet e raportuara në MFE nuk janë përfshirë faturat të cilat nuk kanë mbushur afatin 60 ditor për likuidim. Detyrimet e pa papaguara gjithsej në vlerën 74,300,773 lekë nga mungesa e fondeve kryesisht nga të ardhurat veta të cilat për vitin 2023 nuk janë realizuar në vlerën 86,892,595 lekë, vijjnë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësisive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91.

- *Efektet e zbatimit të vendimeve gjyqësore në buxhet.*

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Peqin ka administruar 9 vendime gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 25,883,318 lekë, i cili përbën efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore. Nga shuma e mësipërme janë zbatuar (likuiduar) në vlerën 6,586,345 lekë, mbetur për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2024 vlera 19,296,973 lekë nga të cilat 4 raste për “detyrim kontrate” fatura të pa likuiduara në vlerën 15,318,445 lekë, dhe 5 raste për largime të pa drejta nga puna në vlerën 6,319,662 lekë. Pra sa më sipër, u konstatua se edhe pse këto vendime gjyqësore kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga Bashkia Peqin, por janë kryer nga përmbaruesit privat duke rënduar buxhetin e shtetit për tarifat përmbarimore me kosto shtesë në shumën prej 2,063,974 lekë, në papajtueshmëri me përcaktimet e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku përcaktohet..... të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësisive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, të dhënat paraqiten në pasqyrën Aneks 2/5, bashkëlidhur RPA.

- *Dokumentacioni mbi çeljen dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes Ministrisë, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;*

Nga të dhënat e paraqitura për periudhën objekt auditimi rezulton se Bashkia Peqin ka përfituruar fonde nga Ministritë në vlerën 52,182,202 lekë nga të cilat janë likuiduar gjatë vitit në vlerën 52,182,202 lekë, për objekte të dhënat në pasqyrën Aneks 2/6, bashkëlidhur RPA.

Për veprimet dhe mosveprimet në përputhe ngarkohen me përgjegjësi znj. O.S. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Financës dhe Buxhetit, për periudhën e auditimit dhe I.S me detyrë Drejtore e Financës, për periudhën qershor 2023 e në vazhdim.

2.2.5. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Drejtoria e Ardhurave, Leje e Licencave e miratuar me VKB nr. 63, datë 23.12.202 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për vitin 2023” e ndryshuar konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1572/1, datë 10.01.2023, me 14 punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor, 1(një) Përgjegjës Sektori dhe 12 Specialist.

Tabela 1. Të dhënat mbi subjektet.

Lloji Biznesit	Viti 2023			
	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	435	27	21	441
B. Madh	50	1	0	51
Institucione	8	0	0	8
Gjithsej	493	28	21	500

Burimi. Bashkia Peqin

Për vitin 2023, pranë bashkisë Peqin kanë ushtruar aktivitet 500 subjekte (441 subjekte të biznesit të vogël, 51 subjekte të biznesit të madh dhe 8 subjekte të tjera institucione)

Paketa fiskale për periudhën objekt auditimi janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 64 datë 23.12.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Peqin 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 1575/1 prot., datë 09.01.2023, ku sipas saj janë planifikuar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023.

Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizimi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore paraqiten në pasqyrën Aneks nr. . 2/1 bashkëlidhur.

Nga të dhënat rezulton se, për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej, nga 173,167 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 86,275 mijë lekë ose 50 %, **me një mosrealizim në vlerën 86,892 mijë lekë (të ardhura tatimore nga 86,200 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 22,168 mijë lekë ose 25,7%, të ardhura jo tatimore nga 69,467 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 42,075 mijë lekë ose 60.5 % dhe të ardhura taksat e ndara nga 17,500 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 22,031 mijë lekë ose 125 %), mungesë të ardhurash** në buxhetin e bashkisë, **veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”,** i ndryshuar, neni 22 dhe neni 23, VKB nr.78 datë 15.11.2021“Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2022”

Me mosrealizim paraqiten taksa për ndërtesën nga familjarët e cila nga 17,611,740 lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 3,900,000 lekë ose 22%, taksa mbi tokën e cila nga 22,000,000 lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 8,028,454 lekë ose 36%, Taksa mbi truallin nga 4,000,000 lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 778,673 lekë ose 19%, Taksa e reklamës nga 2,000,000 lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 264,500 lekë ose 13%, Tarifë pastrimi nga familjarët nga 17,460,000 lekë është realizuar në vlerën 4,812,000 lekë ose 27%.

Sa më sipër për taksat familjare nuk ka një regjistër për sipërfaqen e tokës së ndarë për çdo familje dhe sipërfaqet e ndërtesave të banimit, kështu planifikimi i tyre është bërë sipas realizimit të një viti më parë dhe jo mbi bazën e të dhënave që Drejtoria e të Ardhurave duhet të merrte nga regjistri elektronik i ASHK, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 22, pika 1, ku përcaktohet se.... *Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi, neni 23, pika 1, ku përcaktohet seBaza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.*

Nga të dhënat e Sektorit të Tatimit Taksave, për vitet 2023 të ardhurat për taksat dhe tarifën vendore të cilat mbledhen me agjent tatimorë paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Viti 2023	
		Plan	Fakt
1	Tatim mbi Biznesin e vogël	3,000,000	8,600
2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	11,000,000	11,229,789
3	Taksa e rentës minerare	500,000	3,110,850
4	Taksa mbi të ardhurat personale	6,000,000	10,490,376
	Totali	20,500,000	24,839,615
	Realizimi	121%	

Përsa më sipër konstatohet se: Tatimi mbi biznesin e vogël, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit.

Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia.

Taksa e rentës është planifikuar sipas realizimit të vitit të mëparshëm po kështu dhe TAP është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë, të cilat për vitin 2023 rezultojnë me tejkalim.

Likuidimet janë kryer pa patur të dhëna mbi bazën e të cilave bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 117 dhe UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifa vendore **në vlerën gjithsej 36,951,278 lekë**, nga të cilët 230 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 14,372,078 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks 2/2 bashkëlidhur dhe 5688 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën 22,579,200 lekë, që disponojnë Nj/Administrative të Bashkisë, në mënyrë të përmbledhur pasqyra e debitorëve si më poshtë:

EMËRTIMI	31.12.2022		31.12.2023	
	Vlera	Nr. Subjekte e familje	Vlera	Nr. Subjekte e familje
Debitorë në total	30,894,558	5 528	36,951,278	5918
Biznesi i madh	2,558,952	15	4,795,402	20
Biznesi i vogël	9,031,606	223	9,576,676	210
Familje për taksa tarifa	19,304,000	5320	22,579,200	5688

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se debitorët e vitit 2023, të krahasuar me vitin 2022 janë në rritje si në numër ashtu dhe në vlerë, kështu debitorë për vitin 2023, janë 230 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 14,372,078 lekë dhe 5688 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore në vlerën 22,579,200 lekë, krahasuar me vitin 2022 kanë qenë 238 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 11,590,558 lekë dhe 5320 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore në vlerën 19,304,000 lekë.

Tabela 2. Të dhanë mbi strukturën e borxhit.

Mosha e Borxhit	2023	
	Vlera	Nr. Subjekte
Totali	14,372,078	230
1 vit	6,479,358	148
2 vjet	4,480,337	49
3 vjet	3,412,383	33

Birimi. Hartuar nga grupi i KLSH

Tabela 3. Statusi i debitorëve viti 2023

Statusi i subjekteve debitorë	2023	
	Vlera	Nr. Subjekte
Totali	14,372,078	230
Aktiv	14.372.078	230
Pasiv ose Mbyllur	0	0

Birimi. Hartuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se nga totali i subjekteve prej 230 që janë debitorë në vlerën 14,372,078 lekë, rezultojnë se kryejnë aktivitet 230 subjekte dhe nuk kanë shlyer detyrimet në nga drejtoria e të ardhurave nuk kanë ndjekur procedurë për mbledhjes me forcë të detyrimeve, në kundërshtim me në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ndërsa **vlera prej 22.579.200 lekë janë debitorë 5688 familje të për taksat e tarifave vendore me datë 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve sipas pasqyrës si mëposhtëm:**

lekë

Nr.	Bashkia	Taksa vendore		Tarifa Vendor + gjoba	Shuma taksa tarifa	Numri i familjeve
		Takse Toke	Taksë Ndërtese			
1	Peqini	873.200	978.000	1.804.000	3.655.200	1.345
2	Gjocaj	2.590.200	1.320.000	898.400	4.808.600	1.123
3	Karin	935.700	276.000	256.800	1.468.500	321
4	Përparim	2.262.000	1.234.800	823.200	4.320.000	1.029
5	Pajovë	2.791.850	1.478.400	985.600	5.255.850	1.232
6	Shezë	1.795.050	765.600	510.400	3.071.050	638
	Shuma	11.248.000	6.052.800	5.278.400	22.579.200	5.688

Konstatimi: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Peqin konstatohet se në fund të periudhës janë 230 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 14,372,078 lekë dhe 5688 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore në vlerën 22,579,200 lekë, krahasuar me vitin 2022 kanë qenë 238 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 11,590,558 lekë dhe 5320 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore në vlerën 19,304,000 lekë, nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është ndjekur procedurë për mbledhjes me forcë të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

- Nga auditimi për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë rezultoi se:

Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Peqin për periudhën e vitit 2022 nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, përse i përket arkëtimin të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Peqin, konkretisht të Kapitullit II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e

procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar, në të përcaktohet që:

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njëjësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njëjësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."

Sipas të dhënave nga Drejtoria e të Ardhurave, në territorin e Bashkisë Peqin ushtrojnë aktivitet tregtim të karburanteve 10 subjekte, nga të cilët pajisur me licensë 4 subjekte të cilat kanë likuiduar detyrimet fiskale, ndërsa **6 subjekte** ushtrojnë aktivitet pa u paisur me Autorizim/Licenca për shitje karburanti, duke mos paguar vlerën për tarifën e autorizimit prej 1,000,000 lekë/subjekti ose **6,000,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhehtin e bashkisë Peqin, konkretisht subjektet:**

Tabela 6. Regjistri i subjekteve që tregtojnë karburante.

Nr.	Subjekti	NIPT	Vendndodhja	Tarif audotizimi
1	Shoq. "B" sh.p.k Z. D.B	KXXB	Peqin	1,000,000
2	Shoq. "D.O" sh.p.k Z. D.XH	LXXG	Pajove	1,000,000
3	Shoq. "J. P" sh.p.k Z. G.P	KXXU	Përparim	1,000,000
4	Shoq. "B" sh.p.k Z. B.B	JXXB	Pajove	1,000,000
5	Shoq. "D" Z. N.D	LXXR	Gjocaj	1,000,000
6	Shoq. "B" shpk Z. B.B	LXXF	Gjocaj	1,000,000
	Shuma			6,000,000

Burimi. Nga grupi i KLSH

Nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është ndërmarrë asnjë masë për paisjen e tyre me autorizim me qëllim arkëtimin e detyrimeve, duke i lejuar që të ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" neni 22, pika 3, germa "dh" me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9 dhe VKB për miratimin e paketës Fiskale, për vitin 2023.

- Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi dhe lejet legalizimit.

Për llogaritjen dhe arkëtimin e kësaj takse për vitin 2023, është e ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për vitin 2023, janë miratuar 9 leje ndërtimi me sipërfaqe nën 250 m², për të cilat në zbatim të paketës fiskale është llogaritur taksë e ndikimit në

infrastrukturës 2% , në vlerën gjithsej 673,081 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 2/3, bashkëlidhur.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Aluizni Elbasan janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Elbasan. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **132 persona** me vlerë **6,151,138 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Peqin**, rezulton se nga Drejtoria e Urbanistikës, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3/c, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 23,447,723 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh”., të dhënat sipas pasqyrës Aneks 2/4 bashkëlidhur

Konstatimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Aluizni Elbasan janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Elbasan. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **132 persona** me vlerë **6,151,138 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Peqin**, rezulton se nga Drejtoria e Urbanistikës, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3/c, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 23,447,723 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh”., të dhënat sipas pasqyrës Aneks 2/4 bashkëlidhur të RPA.

Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të trajtuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. V.M, me detyrë Drejtor i të Ardhurave, për periudhën qershor deri 31.012.2023 dhe J.S me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023.

Për vitin 2023, Në përputhje me kërkesat e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” si dhe të UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave

financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 408 prot., datë 28.02.2024, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga znj. I S si nëpunës zbatues dhe Kryetar i Bashkisë, Nëpunës autorizues.

Mbajtja e kontabilitetit v. 2023.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar Bashkia Peqin; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 2,933,600,171 lekë.

Aktivet 3,114,577,092 lekë

Pasivet 180,976,921 lekë

Aktivet neto 2,933,600,171 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **242,888,602 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 64,499,447 lekë,

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 18,203,215 lekë,

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 160,185,940 lekë,

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
56	Mjete monetare ne bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	61,284,147	35,341,067	25,943,080
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	3,215,300	3,641,200	(425,900)
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		64,499,447	38,982,267	25,517,180

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 61,284,147 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin përbëhet nga: gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” paraqitet në vlerën 40,493,166 lekë (*grandi papërdorur në vlerën 14,315 lekë dhe të ardhura të papërdorura në vlerën 26,177,251 lekë*) dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 20,790,981 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË)”, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 3/1, bashkëlidhur.

Vlera e llogarisë 532 “Vlera të tjera” në shumën 3,215,300 lekë, përfaqëson vlerën 385,000 lekë të pullave të Gjendjes Civile dhe vlerën 2,830,300 lekë, të biletave të tregut.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Peqin në 31.12.2023 paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/2, bashkëlidhur, në vlerën 18,203,215 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,111,696 lekë, llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 4,755,398 lekë dhe nga llogaria “Produkte” në vlerën 246,219 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,548,262 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (3,044,943) lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 2,111,696 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	3,729,481
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	14,391,621
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	16,009,409
Gjendja në 31.12.2023	2,111,696

Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 15,845,300 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	16,853,056
Hyrje gjatë vitit 2023	1,249,250
Dalje gjatë vitit 2023	2,257,006
Gjendja në 31.12.2023	15,845,300

Llogaria 34 “Produkte”, ka vlerën 246,219 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pllakave të varrezave që prodhohen për funeralin.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Peqin.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 361, datë 26.09.2023 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën 01.01.2023-31.12.2023”, është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik, i përbërë nga 5 anëtarë i vlerësimit i përbërë nga 3 anëtarë dhe nxjerrjes jashtë përdorimit, i përbërë nga 3 anëtarë, të aktiveve në përdorim si dhe për të krahasuar gjendjen fizike të aktiveve me gjendjen kontabël, në përfundim të procesit të inventarizimit nga Komisioni është përgatitur relacion për procesin e inventarizimit, ku janë konstatuar vlera materiale të dëmtuara të vlerësuara dhe të nxjerra nga përdorimi për llogarinë 327 “Inventarë i imët” në vlerën 2,257,005 lekë, llogarinë 214 “Instalime teknike Makineri pajisje” në vlerën 3,681,261 lekë, llogaria “Mjete transporti” në vlerën 2,040,000 lekë dhe për llogarinë 218 “Inventarë ekonomik” në vlerën 3,197,238 lekë.

Lista e materialeve për jashtë përdorimit është miratuar me VKB nr. 77, datë 28.12.2023 e konfirmuar nga prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 97/1, datë 29.01.2024.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se është kryer inventarë fizik për llogarinë 31 “Materiale”, llogarinë 32 “Inventarë i imët”, llogarinë 214 “ Instalime teknike Makineri pajisje” llogarinë 215 “Mjete transporti”, llogarinë 214 “ Instalime teknike Makineri pajisje” dhe llogarinë 218 “Inventarë ekonomik” ndërsa për llogaritë e tjera të Aktiveve Afatgjata Materiale nuk është kryer inventarë fizik si rrjedhojë pasqyrat financiare përmbajnë vetëm vlerat kontabël të tyre, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogarive në fund të vitit, veprime në shkelje të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III, pika 30,

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/3 dhe përbëhen :

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 37,981,888 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	31,925,168
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	31,168,347
Pakësimi gjatë vitit 2023 (K)	25,111,627
Gjendja në 31.12.2023	37,981,888

Vlera e debitorëve ne vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 6,056,720 lekë. Peshën më të madhe të debitorëve e zen debitorët për taksat dhe tarifatat vendore të biznesit dhe familjaret në vlerën 36,951,278 lekë dhe debitorë nga KLSH në vlerën 1,030,610 lekë. Analiza e gjendjes së llogarisë. “Debitorë të ndryshëm “dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Debitorë analitik në fund të vitit 2023.

Debitorët analitikë.	Çelja 01.01.2023	Shtesa gjatë vitit 2023 (debi)	Gjendja me 31.12.2023
Debitorë nga KLSH	1,030,610	0	1,030,610
Debitorë biznesi	11,590,558	2,781,520	14,372,078
Debitorë për taksa e tarifa familjare	9,104,000	2,227,200	11,331,200
Debitorë për taksa toke familjarë	10,200,000	1,048,000	11,248,000
Totali	31,925,168	6,056,720	37,981,888

Konstatimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 37,981,888 lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se në kredi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve **për vlerën 6,151,138 lekë**, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 122,204,052 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës 4 të Pasivit për paga, sigurime , tatime dhe

furnitorë të ndryshëm, e cila kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare.

Aktivët Afatgjatë jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 9,980,192 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,082,087 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 16,206,189 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 18,805,112 lekë në rritje për vlerën 2,598,923 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJ/JOM për projektet si më poshtë:

- *Projekti për objektin “Rikonstruksion i Rrugës kryesore të fshatrave Gryksh i vogël – Trash” në vlerën 916,000lekë,*

- *Projekti për objektin “Rikonstruksion i rrugës Qendër-Dalje Bashkia Peqin” në vlerën 1,682,923 lekë.*

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/4, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “Studime dhe projekte”, sipas Formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë jo materiale (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 16,206,189 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 18,805,112 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera për Projektin “Studim, projektim për rikonstruksionin e ujësjellësit Trash Karthën” në vlerën 9,708,000 lekë, që duhet transferuar UK Peqin, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjatë Jo Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMF nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30

Aktivët e afatgjatë materiale (AAM)

Llogaria 210 “Toka,troje Terrene” paraqitet me vlerë neto dhe historike në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 5,612,083 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,612,083 lekë, e cila analizohet si më poshtë :

Toka ndërt. Pallatit tek Portokallet	956,000
Shpronësim rruga e Tatimeve	2,461,469
Lulishte nga ana e sahatit	994,614
Shpronësim toka e varrezave	1,200,000
Totali	5,612,083

Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 10,562,345 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 10,034,228 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 dhe në vitin 2023 në vlerën prej 13,928,877 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 432,589,552 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 421,013,338 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 641,555,117 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 651,608,381

lekë. Pra kemi rritje në vlerën 10,053,264 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për objektet si më poshtë:

-Objekti “Ndërtim i Tregut Fruta Perime” në vlerën 9,600,444 lekë, sipas kontratës nr. 724, datë 04.05.2022, me vlerë 9,600,444 lekë dhe “Supervizim Tregut Fruta Perime” në vlerën 297,058 lekë, sipas kontratës nr. 875, datë 26.05.2022, me vlerë 297,058 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimi si më poshtë vijon:

Urdhër shpenzimi		Fatura		Vlera e faturës	Vlera e likuiduar
Nr.	Datë	Nr.	Datë		
393-394	20.06.2022	35	14.06.2022	4,308,084	4,000,000
731-732	16.12.2022	35	14.06.2022	308,084	308,084
768-769	23.12.2022	41	04.10.2022	5,292,360	791,916
95-96	02.03.2023	41	04.10.2022	5,292,360	4,500,444
239	04.05.2023	24	20.12.2022	297,058	297,058
Totali				9,897,502	9,897,502

Objekti “Supervizim e kolaudim Rikonstruksion i godinave 1 katesh” në vlerën 155,762 lekë, sipas kontratës nr. 1662, datë 25.07.2019, me vlerë 148,802 lekë dhe nr. 2973, datë 10.12.2019, me vlerë 6,960 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimi si më poshtë vijon:

Urdhër shpenzimi		Fatura		Vlera e faturës	Vlera e likuiduar
Nr.	Datë	Nr.	Datë		
561	18.11.2021	295	09.12.2019	6,960	6,960
607	10.12.2021	40	04.11.2019	148,802	148,802
Totali				155,762	155,762

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në pasqyrën Aneks 3/5, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 641,555,117 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 651,608,381 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera për 2 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 3,821,874 lekë (*Depo uji dhe godinë në vlerën 2,321,874 lekë dhe Pusi Fatishe në vlerën 1,500,000 lekë*) që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” duhej transferuar Ujësjellës Kanalizime Peqin, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30

Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 2,002,064,730 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,038,845,623 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 2,638,268,229 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 2,775,152,359 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 136,884,130 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për objektet si më poshtë:

-Objekti “Sistemim dhe asfaltim i rrugës Ali Ceka” në vlerën 1,000,000 lekë, për kontratën nr. 1140, datë 14.05.2019, me vlerë 16,198,620 lekë,

-Objekti “Rehabilitim i Stacionit te pompave Peqin” në vlerën 55,228,360 lekë, sipas kontratës nr. 1892, datë 27.10.2020 me vlerë 55,229,379 lekë,

-Objekti “Mbikëqyrje Rehabilitim i Stacionit te pompave Peqin” në vlerën 1,105,231 lekë, sipas kontratës nr. 1979, datë 09.11.2020 me vlerë 1,105,231. Lekë,

-Objekti “Transformim i Stacionit të pompave Peqin” në vlerën 23,318,429 lekë, sipas kontratës nr. 1638, datë 23.07.2019, me vlerë 25,474,241 lekë,

-Objekti “Mbikëqyrje Transformim i Stacionit të pompave Peqin” në vlerën 340,299 lekë, sipas kontratës nr. 1688, datë 26.07.2019 me vlerë 453,732 lekë,

-Objekti “Ndërtim i pritave Lumore dhe Përforcim i këmbëve të urës në shtratin e lumit Shkumbin” në vlerën 55,420,226 lekë, sipas kontratës nr. 1613, datë 13.10.2022 me vlerë 55,424,395 lekë,

Objekti “Mbikëqyrje e objektit ndërtim dhe sistemin i përroit të Rrushtës” në vlerën 471,585 lekë, sipas kontratës nr. 692/1, datë 16.04.2021 me vlerë 471,585 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimi sipas pasqyrës Aneks nr. 3/6, bashkëlidhur.

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/7, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 2,638,268,229 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 2,775,152,359 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera për 33 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 576,162,053 lekë, që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” që duhej transferuar në Ujësjellës Kanalizime Peqin, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas të dhënave të pasqyrës Aneks nr. 3/8, bashkëlidhur.

Llog 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 3,822,202 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,171,973 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 23,743,152 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 21,367,212 lekë. Kjo llogari është shtuar për vitin 2023 në vlerën 1,305,321 lekë për blerje me pagesë, për blerje Pajisje kompjuterike në vlerën 639,000 lekë, për faturat nr. 5191, datë 04.07.2023 dhe nr. 714 datë 20.09.2024 dhe shtesa pa pagesë për kompjuter të ardhura nga Drejtoria Arsimore Peqin në vlerën 666,321 lekë sipas (FD 43,44,45,46,47,48 dhe 50 datë 27.02.2023) të cilat janë ber hyrje me (FH nr. 6, datë 11.09.2023, nr. 8, 9, 13,,15, 16, 17, 18, datë 14.11.2023).

Gjithashtu gjatë vitit 2023 kemi pakësim në vlerën 3,681,261 lekë nga daljet jashtë përdorimit Bazuar në Urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr. 361, datë 26.09.2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit, komisionit të vlerësimit dhe të komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit” sipas P. Verbaleve të hartuara për këtë qëllim dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 28.12.2023 dhe konfirmimit të Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.97/1, datë 29.01.2024.

Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 6,570,311 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,256,249 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 18,163,600 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 20,203,600 lekë.

Kjo llogari gjatë vitit 2023 kemi pakësim në vlerën 2,040,000 lekë nga nxjerrja jashtë përdorimit e mjetit tip “benx avangart” sipas VKB nr. 32, datë 21.06.2023, Prefektit të Qarkut Elbasan me

nr. 788/1 date 11.07.2023, sipas proces verbalit të mbajtur në datë 20.06.2023, nga komisioni me specialistë i ngritur për këtë qëllim me urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 204, datë 20.06.2023 Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/9, bashkëlidhur.

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,103,120 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 12,316,496 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 është e analizuar për 1336 artikuj kontabël në vlerën 55,462,570 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 për 1215 artikuj në vlerën kontabël 52,499,332 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 234,000 lekë, për blerje pajisje me faturën nr. 714, datë 20.09.2014.

Është pakësuar për vlerën 3,197,238 lekë nxjerrje jashtë përdorimit Bazuar në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 361, datë 26.09.2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit, komisionit të vlerësimit dhe të komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit” sipas P. Verbaleve të hartuara për këtë qëllim dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.77, datë 28.12.2023 dhe konfirmimit të Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.97/1 datë 29.01.2024.

Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF, paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/10, bashkëlidhur.

Llogaria 231 “AAGJM Investime në proces” paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 462,323,947 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 363,356,413 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2023, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Analiza e këtyre investimeve sipas llogarive dhe kontratave paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/11, bashkëlidhur.

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Peqin në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (1,048,804,879) lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (129,048,096) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat:

202 Amortizim i studimeve e kërkimeve 1,497,028 lekë

211 Pyje kullota plantacione 528,117 lekë

212 Ndërtime e konstruksione 21,629,478 lekë

213 Rruge rrjete vepra ujore 10,103,237 lekë

214 Instalime teknike, pajisje, vegla pune 955,550 lekë

215 Mjete transporti 1,314,062 lekë

218 Inventari ekonomik 3,020,624 lekë

Pakësimi në vlerën 8,918,499 lekë, për nxjerrje jashtë përdorimit:

214 Instalime teknike, pajisje, vegla pune 3,681,261 lekë

215 Mjete transporti 2,040,000 lekë

218 Inventari ekonomik 3,197,238 lekë

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Akivet afatgjata me vlerë neto”, paraqitet në Aneksin nr. 3/12, bashkëlidhur.

Konstatime: Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.

Nga auditimi ka rezultuar se, nga 208 objekte inventari të AAM me kosto historike në vlerën 3,432,327,823 lekë, Bashkia Peqin nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në

dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Mbi rivlerësimin e aktiveve materiale afatgjata.

Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Peqin, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 4 objekte shkolla variojnë nga 5,000 lekë deri në 10,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llog e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Peqin më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	29,466,810	32,688,248	(3,221,438)
42	Detyrime ndaj personelit	21,750,655	36,915,482	(15,164,827)
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,410,945	963,808	447,137
435	Sigurime shoqërore	4,059,950	3,875,925	184,025
436	Sigurime shëndetësore	554,870	531,189	23,681
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	20,790,981	23,290,504	(2,499,523)
467	Kreditorë të ndryshëm	102,942,710	94,448,216	8,494,494
	Gjendja më fund të periudhës	180,976,921	192,713,372	(11,736,451)

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqiten detyrimet për fatura të pa likuiduara të cilat për vitin 2023 paraqiten në vlerën 29,466,810 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/13, bashkëlidhur.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 21,750,655 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2023	36,915,482
Shtesa (K)	176,095,587
Pakësime (D)	191,260,414
Gjendja në 31.12.2023(K)	21,750,655

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, sipas pasqyrës Aneks nr. 3/14, bashkëlidhur.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,410,945 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2023	963,808
Shtesa (K)	11,456,696
Pakësime (D)	11,009,559

Gjendja në 31.12.2023 (K)	1,410,945
----------------------------------	------------------

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, sipas pasqyrës Aneks nr. 3/15, bashkëlidhur.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 që paguhen në muajin janar 2024 dhe janë përkatësisht në vlerat 4,059,950 lekë dhe 554,870 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2023	3,875,925
Shtesa	51,359,704
Pakësime	51,175,679
Gjendja në 31.12.2023	4,059,950
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2023	531,189
Shtesa	7,008,709
Pakësime	6,985,028
Gjendja në 31.12.2023	554,870

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, sipas pasqyrës Aneks nr. 3/16, bashkëlidhur.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogaritje paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 23,290,504 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 20,790,981 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, e cila paraqitet, në pasqyrën Aneks nr. 3/17, bashkëlidhur.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara dhe vendime gjykate të cilat për vitin 2023 paraqiten në vlerën 102,942,710 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/18, bashkëlidhur.

Në mënyrë analitike detyrimet për vendime gjyqësore paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr	Emri	Nr. vendimit	Detyrime 2022 e para	Shtesa gjatë vitit 2023	Likuidim gjatë vitit 2023	Gjendja në fund të vitit 2023
1	D S	Nr.Vendimi 1840 date 25.03.2021	250,000	-	250,000	0
2	Ç (K.D)	Nr.Vendimi 270 date 01.04.2021	474,735	-	474,735	0
3	Ç (M)	Nr.Vendimi 888 date 08.01.2020	250,000	-	250,000	0
4	A Gj (LI)	Nr.Vendimi 384 date 21.06.2022	1,751,678	-	800,000	951,678
5	E G	Nr.Vendimi 1518 date 06.03.2020	8,228,169	-	700,000	7,528,169
6	D M	Nr.Vendimi 435 date 23.04.2022	9,536,208	-	2,697,610	6,838,598
7	Z D	Nr.Vendimi 75 date 31.03.2021		3,337,097	414,000	2,923,097
8	E J	Nr.Vendimi 264 date 02.06.2023		663,520	-	663,520
9	E Shpk	Nr.Vendim 2098 date 04.10.2023		609,308	-	609,308
		Totali				19,514,370

Konstatimi: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është pasqyruar në vlerën 102,942,710 lekë nga auditimi ka rezultuar se nuk janë përfshirë në këtë llogari si detyrime të pa likuiduara vlera prej 37,981,888 lekë, që i përkasin debitorëve për taksa e tarifa vendore, për të cilat duhet të pasqyroheshin në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, duke sjellë një shtesë dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve, veprime në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi

1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d
 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”

Fondi i konsoliduar për vitin 2022, sipas formatit nr.1 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,933,600,171	2,985,071,722
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,526,535,292	2,507,056,012
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	40,493,166	12,050,563
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	363,356,413	462,323,947
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim	3,215,300	3,641,200
109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		

Analizë: Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën **815,125,404 lekë**, paraqitet si më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet “paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën **41,674,544 lekë**, e analizuar:

Tatim mbi të ardhurat në vlerën 237,229 lekë,

Tatim mbi pasurinë në vlerën 17,508,695 lekë,

Tatim mbi mallrat e shërbimet brenda vendit në vlerën 23,910,420 lekë,

Të tjera tatim e taksa kombëtare në vlerën 18,200 lekë.

Gjendja e llogarisë sintetike 71 “Të ardhura jo tatimore “paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën **15,984,942 lekë**, e analizuar:

Nga ndërmarrjet dhe pronësia në vlerën 2,367,605 lekë,

Tarifë administrative dhe rregullatorë në vlerën 13,617,337 lekë.

Gjendja e llogarisë sintetike 7 “Grante korrente” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **757,465,918 lekë**, e analizuar:

Nga buxheti për NjQP(Vendore) në vlerën 624,114,640 lekë,

Pjesëmarrje e institucioneve në tatim taksa në vlerën 10,801,226 lekë,

Financim i pritshëm nga buxheti në vlerën 122,204,052 lekë.

Të tjera nga grande korrente në vlerën 346,000 lekë.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2023 , të cilat në total janë në vlerën **774,632,238 lekë** paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 210,729,348 lekë.

Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 34,362,902 lekë.

Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 126,396,203 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,759,553 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 395,835,970 lekë.

Për vitin 2022 totali i te ardhurave në vlerë është **815,125,404 lekë** dhe totali shpenzimeve është **774,632,238 lekë**. Diferenca e tyre në vlerën 40,493,166 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit “i cili paraqitet në vlerën 40,493,166 lekë.

- Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. U krye verifikimi i likuidimeve të kontratave për mallra, shërbime e punime ndërtimi ku rezultoi se ato janë kryer brenda afateve të paraqitjes së faturës për të cilën Drejtoria e Financës ka plotësuar urdhër-shpenzime për likuidimin e tyre. Mallrat e blera gjatë vitit janë bërë hyrje në magazinë sipas kronologjisë së blerjeve dhe me kërkesë e urdhër dorëzimi janë bërë dalje nga magazina të firmosura nga përgjegjësi materiale.

Për sa më sipër mbahet ky akt konstatimi me znj. I.S me detyrë Drejtore e Financës, për periudhën e auditimit.

2.4. Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

Në zbatim të pikës 4 mbi “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve, pyje dhe kullota)”, të programit të auditimit nr. 491/1 datë 15.04.2024 për auditimin financiar ushtruar në Bashkinë Peqin, janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Peqin
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastër
- Inventari i fondit pyjor
- Kontratat e lidhura për dhënie me qira të fondit pyjor

I. PASURITË E PALUAJTSHME

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për bashkinë Peqin, lista e pronave është miratuar me VKM nr.510 datë 06.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peqin”, i ndryshuar me VKM nr.823 datë 23.11.2011.

Në total, nga 246 pasuri që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Peqin, pa përfshirë ish-komunat, vetëm 14 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar.

Tabela 1. Lista e pronave

Bashkia/Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Në pronësi	Në përdorim	Prona të regjistruara në Kadastër
1 Bashkia Peqin	344	246	98	14
2 NJA. Gjocaj				Nuk ka listë përfundimtare

3	NJA. Karinë	376	365	11	0
4	NJA. Përparim				Nuk ka listë përfundimtare
5	NJA. Pajovë				Nuk ka listë përfundimtare
6	NJA. Shezë				Nuk ka listë përfundimtare
Totali					

Burimi: Bashkia Peqin

Për ish-Komunën Gjocaj:

- Me VKM nr.472 datë 18.07.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore” është bërë vetëm miratimi i listës fillestare
- Me VKM nr.941 datë 23.12.2012 është miratuar lista paraprake

Sa më sipër nuk rezulton të ketë Vendim të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës përfundimtare të pronave.

Për ish-Komunën Përparim:

- Me VKM nr.302 datë 09.05.2012 është miratuar lista paraprake për transferimin e pronave, me qëllimin afishimin dhe përditësimin e tyre.

Për ish-Komunën Shezë:

- Me VKM nr. 90 datë 31.01.2007 është miratuar lista paraprake për transferimin e pronave, me qëllimin afishimin dhe përditësimin e tyre.

Për ish-Komunën Pajovë:

- Me VKM nr.256 datë 12.03.2009 është miratuar lista paraprake për transferimin e pronave, me qëllimin afishimin dhe përditësimin e tyre.

Për ish-Komunën Karinë:

- Me VKM nr.749 datë 05.09.2013 është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme shtetërore që transferohen në pronësi të Komunës Karinë, ku rezultojnë 365 prona në pronësi dhe 11 në përdorim, që i përkasin tokave me funksion bujqësor.

Sipas llojit të funksionit, për këtë komunë rezultojnë të dhënat si mëposhtë:

<u>Funksioni</u>	<u>Pronësi</u>	<u>Përdorim</u>
Për realizimin e shërbimeve arsimore	8	
Për shëndetin publik	2	
Për shërbimin funeral	20	
Për shërbime publike, troje	17	
Për shërbime bujqësore(toka bujqësore)		11
Për shërbime bujqësore(toka inproduktive)	97	
Infrastrukturë rrugore	217	
Prona për zhvillim ekonomik	2	
Sheshe	2	

Nga pasuritë e mësipërme nuk rezulton të jetë e regjistruar asnjë pasuri në regjistrat publike të pasurive të paluajtshme.

Për Bashkinë Peqin

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Peqin nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Në lidhje me pronat për të cilat Bashkia Peqin disponon dokument pronësie rezulton se nga 20 prona, vetëm 8 prona kanë certifikatë pronësie ndërsa 13 pasuri janë me vërtetime hipotekore, çka nënkupton se për to nuk ka kartelë pasurie në regjistrat publike dhe se nuk është aplikuar në

ASHK për kalimin nga sistemi i vjetër hipotekor në sistemin e ri të certifikimit, për zona kadastrale ku ka mbaruar procesi i regjistrimit fillestar.

Tabela 2: Të dhënat mbi pronat me vërtetim hipotekor

	Prona	Nr. pasurisë	Sipërfaqe truall m2	Sipërfaqe ndërtesë m2	Dokumenti
1	Kati i parë i godinës së Bashkisë(Urdhër nr.730 datë 23.11.2009 të Ministrisë së Brendshme)	13/45+1-1	169	161	Vërtetim hipotekor datë 07.12.2009
2	Kati i dytë i ndërtesës (Urdhër nr.730 datë 23.11.2009 të Ministrisë së Brendshme)			228	Vërtetim hipotekor datë 07.12.2009
3	Truall	13/140	105.2		Vërtetim hipotekor datë 14.01.2010
4	Palestra	16/34	320	260	Vërtetim hipotekor datë 15.05.2012
5	Qendër shëndetësore(L.N)	14/136		68	Vërtetim hipotekor datë 12.07.2012
6	Qendër shëndetësore(L.N)	13/179		34	Vërtetim hipotekor datë 14.01.2010
7	Varreza(VKM nr.510)	4/102	16,109		Vërtetim hipotekor datë 31.10.2012
8	Varreza (VKM nr.510 datë 16.07.2011)	4/103	1045		Vërtetim hipotekor datë 31.10.2012
9	Tribuna e stadiumit(VKM nr.510 datë 16.07.2011)	16/38/1	580	308	Vërtetim hipotekor datë 14.05.2012
10	Fusha sportive VKM nr.510 datë 16.07.2011)	16/38	14235		Vërtetim hipotekor datë 14.05.2012
11	Sheshi para Pallatit të Kulturës VKM nr.510 datë 16.07.2011)	7/124	1124		Vërtetim hipotekor datë 31.10.2012
12	Pallati i Kulturës	7/123	1380	1226	Vërtetim hipotekor datë 31.10.2012
13	Kopshti i fëmijëve	14/10	451	341	Vërtetim hipotekor datë 16.06.2023
14	Shkolla e vjetër VKM nr.510 datë 16.07.2011	17/44	576	418	Certifikatë pronësie datë 13.02.2019
15	Truall	96/2	282		Certifikatë pronësie datë 31.12.2013
16	Shesh + skarpate	69/1	134,468		Certifikatë pronësie 31.12.2013
17	Shtesë varreza (shpronësim)	232/6	4000		Certifikatë pronësie 18.04.2016
18	Tregu industrial	96/3	2891		Certifikatë pronësie 18.06.2016
19	Terrene sportive	103	19695	130	Certifikatë pronësie 18.06.2016
20	Pikë grumbullimi të plehërave	108/1	7000		Certifikatë pronësie 18.06.2016
21	Godina e ish-SHISH	8/85	270	160	Certifikatë pronësie 18.06.2016

Burimi. Bashkia Peqin

Lista e mësipërme prej 21 prona përfshin pasuri që nuk janë pjesë e inventarit të pasurive të transferuara. Kështu, pasuritë me numër rendor sipas tabelës 1-2, nuk janë pjesë e inventarit por sipas shënimit rezultojnë të jenë regjistruar me një urdhër ministri, ndërsa pasuria me nr.232/6 me sipërfaqe 4000 m² truall është përfituar përmes procedurave të shpronësimit. Po ashtu, dy qendrat shëndetësore janë ndërtuar me leje ndërtimi ndërsa pasuritë me numër 96/2 truall dhe 69/1 “shesh+skarpate” i korrespondojnë vetëm një numër pasurie të inventarit.

Në lidhje me pronat në fushën e arsimit rezulton me vërtetim hipotekor datë 18.06.2013 vetëm pasuria e llojit “truall+ndërtesë”, me nr. 14/10, ndërsa pasuritë e llojit shkollë nuk janë të regjistruara, ndonëse përgjatë viteve janë realizuar rikonstruksione të tyre, e për pasojë ndryshimet në strukturë apo shtesat në sipërfaqe që janë bërë nuk janë reflektuar në regjistrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Tabela 3. *Lista e pronave të shkollave*

Zona kadastrale	Lloji i pronës	Nr.pasurie	Emri	Sip totale m ²	Sip. Ndërtesë m ²
2908	Truall+ ndërtesë	8/100	Shkolla e mesme “Zihni Magani”	5938	1362
2908	Truall+Ndërtesë	8/100/1	Shkolla 8 vjeçare “Demir Godelli”	4554	336
2908	Truall+Ndërtesë	16/6	Shkolla 8 vjeçare “Adem Bedalli”	470	365
2908	Truall+Ndërtesë	14/10	Kopsht	451	341

Burimi. Bashkia Peqin

Në lidhje me pronat që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik, në listën e inventarit rezulton vetëm një qendër shëndetësore me numër rendor 163, nr. 3/12/2 pasurie e llojit truall +ndërtesë, me sipërfaqe 1440 m² truall dhe 1440 m² ndërtesë, e cila nuk është e regjistruar në ASHK. Dy qendrat shëndetësore, përkatësisht me nr.14/136 dhe 13/179, për të cilat bashkia Peqin disponon dokumente pronësie, vërtetim hipotekor, janë ndërtuar me leje ndërtimi dhe nuk rezultojnë se kanë marrëdhënie me truallin.

Në lidhje me pronat që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore sportive me numër rendor 142-145; 341-343, rezultojnë pasuritë sipas tabelës si mëposhtë.

Tabela 4. *Lista e pronave për veprimtari social-kulturore*

	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Nr.pasurie	Emri	Sip totale m ²	Sip. Ndërtesë m ²
142	2908	Truall	16/38	Fushë sporti	14235	
143	2908	Truall+ndërtesë	7/82	Pallati i Kulturës(pjesa e përparme)	3934	720
144	2908	Truall+ndërtesë	7/95	Pallati i kulturës (pjesa e pasme)	148	148
145	2908	Truall	7/84	Shesh përpara Pallatit të Kulturës	496	
341	2908	Truall +ndërtesë	16/38/1	Tribuna e stadiumit	580	580
342	2908	Truall+Ndërtesë	16/34	Palestra e peshëngritjes	320	260
343	1112	Truall+ndërtesë		Terren sportiv te pishat	19695	130

Sa i përket Pallatit të Kulturës, me numër rendor 143-145, Bashkia e Peqinit disponon dy vërtetime hipotekor datë 31.10.2012 për pronat si mëposhtë :

- Pasurinë me nr.7/124(sheshi para Pallatit të Kulturës) me sipërfaqe trualli 1124 m²
- Pasurinë me nr. 7/123 Pallati i kulturës me sipërfaqe trualli 1380 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 1226 m².

Nga auditimi rezultoi se në total Bashkia Peqin disponon vërtetime hipotekore për sipërfaqe totale 2504 m² truall dhe 1266 m² ndërtesë ndërkohë që sipas inventarit përfundimtar, pasuritë e lidhura me objektin Pallati i Kulturës kanë një sipërfaqe totale 4578m² truall, ose 2074 m² truall më pak sesa inventari. Ky mosrakordim buron edhe nga fakti se Bashkia Peqin disponon vërtetime hipotekore, të cilat duke qenë se nuk kanë kartela të hapura në regjistrat e pasurive të

paluajtshme (pasi nuk kanë kaluar në sistemin e regjistrimit/certifikimit) krijon risqe të cenimit të tyre nga aplikimet për legalizime apo tjetërsime të tjera.

Sa i përket tribunës së stadiumit, sipas inventarit rezulton se ka një sipërfaqe trualli 580 m² dhe sipërfaqe ndërtese 580 m², ndërsa në vërtetimin hipotekor datë 04.05.2022, për këtë pasuri rezulton sipërfaqja e ndërtesës prej 308 m² ose 272 m² më pak sesa përcakton inventari(konfirmuar edhe nga ASIG, sipërfaqja është më e madhe se 308m²).

Në lidhje me pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, me numër rendor: 113-138;172-173;335-337, në total janë 31 pasuri, nga të cilat Bashkia Peqin ka dokument pronësie për:

- Certifikatë pronësie për pikën e grumbullimit të plehrave, pasuria me nr.108 me sipërfaqe 7000m² që i korrespondon pasurisë me numër rendor 337 sipas inventarit
 - Certifikatë pronësie datë 18.06.2013 për tregun industrial+fruta perime , pasuria me nr.96/3 me sipërfaqe 2891 m², por që nuk korrespondon me numrin rendor 336, që mbart nr.pasurie 99 me sipërfaqe 2921 me një diferencë 30 m².
 - Certifikatë pronësie datë 13.02.2019 me sipërfaqe 576 m² truall dhe 418 m² ndërtesë
- Si rrjedhojë, për pronat me funksion për zhvillimin ekonomik rezultojnë 28 pasuri të paregjistruara.

Në lidhje me pronat që përdoren në fushën administrative, me numër rendor 146;344, rezultojnë pronat si mëposhtë:

- Pasuria me nr.5/86, truall+ndërtesë me emërtesës Stacioni i Makinave dhe Traktorëve me sipërfaqe trualli 6362 m² truall dhe 1903 m² ndërtesë, e cila sa i përket ndërtesave rezulton nga ortofotot e ASIG plotësisht e amortizuar dhe nuk është e regjistruar
- Pasuria me nr.585, truall+ndërtesë me emërtesën godina e ish-SHIK, me sipërfaqe 270 m² truall dhe 160 m² ndërtesë, për të cilën rezultojnë faktet si mëposhtë:
 - Bashkia Peqin disponon certifikatën e pronësisë me nr. 1541532 serie, datë 12.07.2018, ku në kartelën e pasurisë së paluajtshme, seksionin “Përshkrim i veçantë” ka shënimin se për këtë pasuri ka leje legalizimi aplikuar në ZVRPP me datë 16.05.2018
 - Me nr.2578797 datë 17.04.2018 është miratuar leja e legalizimi për objekt godinë social-ekonomike 1 kat” me sipërfaqe parcele 500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 170.2 m² ndërtesë, ku sipas hartës treguese të ZVASHK dhe Gen-planit të legalizimi, rezulton të jetë legalizuar objekti shtetëror, përfshirë truallin funksional prej 270 m² për të cilën Bashkia Peqin disponon certifikatë pronësie. Mbi bazën e kësaj leje legalizimi, ky objekt përdoret nga subjekti privat.
 - Me njoftimin nr.6251/1 datë 20.06.2018 Prokuroria Pranë Gjykatës së Parë Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr.1037 për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre” ndaj punonjësve të ALUIZNI dhe punonjësve të ish-ZVRPP Peqin
 - Me vërtetimin nr. 798 prot., datë 24.04.2024 rezulton se është në gjykim çështja penale nr.1037”.

Si konkluzion, nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

- Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Peqin nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “*bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me*

asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”.

- Në bashkinë Peqin vepron vetëm një specialist që mbulon çështjen e pasurive të paluajtshme të transferuara. Ndonëse me urdhrin nr.74 datë 07.03.2024 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar ngritja e një strukture të posaçme për përditësimin e pronave, në pronësi dhe në përdorim ky sektor nuk është reflektuar në organigramën bashkisë, por vijon të jetë me një specialist.
- Në total, nga 246 pasuri i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Peqin, pa përfshirë ish-komunat, vetëm 14 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Në veçanti konstatohet vërehet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to ka realizuar investime përgjatë viteve.
- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Peqin nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.
- Në lidhje me pronat për të cilat Bashkia Peqin disponon dokument pronësie rezulton se nga 20 prona, vetëm 8 prona kanë certifikatë pronësie ndërsa 13 pasuri janë me vërtetime hipotekore, çka nënkupton se për to nuk ka kartelë pasurie në regjistrat publike dhe se nuk është aplikuar në ASHK për kalimin nga sistemi i vjetër hipotekor në sistemin e ri të certifikimit, për zona kadastrale ku ka mbaruar procesi i regjistrimit fillestar.

II. Fondi Pyjor

Bashkia Peqin ka në administrim një fond pyjor dhe kulloror prej 7906 ha, i ndarë në 7 ekonomi pyjore sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar.

Tabela 5. Të dhana mbi fondin pyjorë

Ekonomia Pyjore	Sipërfaqe total HA	shkëmbore	pyll	kullote
Malesia Peqin	5189.33	-	4339.72	849.61
Paper Sollak	622.07	PF-21.35	496.82	103.9
Rrase-Xherije	866.81	-	489.95	376.86
Zalli Shkumbin	426.13	-	426.13	-
Paper Krrabe	699.66	-	574.17	125.49
Baldushk 2	5.11	-	5.11	-
Rove-Lunxhe	97.68	-	97.68	-
Totali	7906.79	21.35	6429.58	1455.86

Burimi. Bashkia Peqin

Si konkluzion, nga auditimi ka rezultuar se:

- Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia e Peqin nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.
- Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr.443/2016 nuk ka regjistruar në regjistrat kadastralë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kulloror publik nuk është regjistruara asnjë sipërfaqe pyjore nga 162 ngastra të transferuara.

- Në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Bashkia Peqin nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

Në bashkinë e Peqinit janë lidhur 9 kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, nga të cilat kanë si objekt aktiviteti “agropylltari” .

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 janë debitorë 6 subjekte në vlerën prej 538,208 lekë.

Tabela 6. Të dhënat mbi subjekte debitorë nga fondi pyjor.

Nr .	Subjekti	Sipërfaqja ne Ha	Emërtimi	Detyrimi Vjetor ne leke 2023	Debitor 2023	Afati
1.	L.K	10.8 ha	Shkurre	108.000	108.000	10 Vjet
2.	T.F	32.5 ha	Shkurre	323.000	-	10 Vjet
3.	A.M	11.61 ha	Kullote	116.100	116.100	10 Vjet
4.	B sh.p.k	7.7 ha	Kullote	77 000	77.000	10 Vjet
5.	B sh.p.k	5.8 ha	Kullote	58 180	58.180	99 Vjet
6.	B sh.p.k	8 ha	Kullote	80 000	80.000	10 Vjet
7.	A.C	8 ha	Kullote	80.000	-	10 Vjet
8	E.K	3.4 ha	Kullote	20.400	-	99 Vjet
9	E.K	5 ha	Pyll	50.000	50.000	10 Vjet
	Kamatvonesë			10%	48928	
	Totali :	92.81 ha		912.680	538,208	

2.5. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit.

Në përmbushje të pikave të programit në auditimin e Bashkisë Peqin, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Zbatimi i kriterëve në verifikimin e procedurave të rekomandimeve:

- “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit.

Referuar auditimit të mëparshëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka kryer auditim në Bashkinë Peqin “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë” (Për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022), ku me shkresën nr. 429/7 Prot, datë 10.10.2023, lënda: “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimit për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Peqin, për të cilën është verifikuar si më poshtë, vijon;

- Mbi hartimin e Plan veprimit dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit 20 ditor dhe raportimi me shkrim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga dhënia e rekomandimeve.

Bashkia Peqin, në zbatim të shkresës nr. 429/7 Prot, datë 10.10.2023, ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, atë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” të Titullarit dhe

për çdo rekomandim të lënë, ka ngarkuar strukturat përkatëse të Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve.

Nga Bashkia Peqin, është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH -së, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet urdhrin të brendshëm me Nr.428 prot, datë 08.11.2023, dërguar pranë KLSH me shkresë Nr. 1907/2 Prot, datë 08.11.2023.

Nga Bashkia Peqin, ende nuk është plotësuar afati 6 mujor, për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

III. Mbi pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në total në Bashkinë Peqin janë rekomanduar gjithsej 51 masa me vlerë 87,495 mijë lekë, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 20 masa me vlerë 157 mijë lekë, janë në proces zbatimi 30 masa me vlerë të mbetur 51,533 mijë lekë (*pasi vlera 15,842 mijë lekë është arkëtuar nga vlera totale*) dhe nuk është zbatuar një masë me vlerë 19,963 mijë lekë, e detajuar:

- *Janë rekomanduar gjithsej 27 masa organizative, të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa dhe janë në proces zbatimi 25 masa;*

- *Janë rekomanduar 3 masa shpërblim dëmi me vlerë 18,920 mijë lekë të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa me vlerë 157 mijë lekë dhe nuk është zbatuar një masa me vlerë 18,763 mijë lekë;*

- *Janë rekomanduar gjithsej 6 masa mos efektivitet me vlerë 68,575 mijë lekë, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 51,533 mijë lekë (*pasi vlera 15,842 mijë lekë është arkëtuar*) dhe nuk është zbatuar një masa me vlerë 1,200 mijë lekë;*

- *Në lidhje me masat disiplinore nga 15 masa, rezulton se janë pranuar dhe zbatuar 15 masa;*

- *Në lidhje me masat e rikëruara rezulton se janë rikëruar 15 masa me vlerë 49,799 mijë lekë, nga ku 10 masa janë zbatuar dhe 10 masa janë në proces zbatimi për vlerën 49,799 mijë lekë.*

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin, u konstatua se:

-Nuk janë hartuar hapat e proceseve të punës për burimet njerëzore .

-Në Bashkinë Peqin, për periudhën objekt auditimi, mungon dokumentacioni shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, në Bashkinë Peqin për vitin 2022 nuk vërtetohet me dokumentacion se GMS ka kryer takime pune për periudhën objekt auditimi. Në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 27, pika 1, gjithashtu dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3, miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016

-Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve,, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8, pika 8, shkronja a, neni 12, pika 3, neni 22, pika 5, neni 16,

pika 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1, pika 3.4, Udhëzimi nr. 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 3.2.5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 19-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Të hartohet dhe miratohet plani i veprimit për dokumentimin shkresor që pasqyron minutat e takimit.

1.2. Rekomandimi: Të hartohet dhe miratohet strategjia për të dokumentuar mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

1.3. Rekomandimi: Të hartohet Plan i veprimit për MFK dhe të raportohet për realizimin e tyre nga sektorët përkatës.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin nuk është hartuar dokument shkresor, por punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. Nga titullari i Bashkisë Peqin, është nxjerrë urdhri nr.380, datë 11.10.2023 “Për krijimin e grupit për hartimin e planit strategjik për menaxhimin e riskut”. **Rekomandimi është proces zbatimi.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit për organizimin dhe funksionimin e Auditit të Brendshëm në Bashkia Peqin rezultoi se struktura e kësaj njësie përbëhet nga 3 punonjës nga të cilët drejtuesi i njësisë është i pajisur me certifikatë të auditit, një prej tyre është në proces marrje dhe certifikatës dhe një punonjës është i pa pajisur me certifikatë të auditit të brendshëm. Bazuar në pikën 3 të VKM nr.32, datë 03.02.2018 përcakton se struktura e auditit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si audites të brendshëm në sektorin publik.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Peqin të vazhdojë ndjekja e trajnimeve të vijueshme profesionale për specialistët e Nj.A.B.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Në lidhje me certifikimin e audituesit të brendshëm, janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin në kursin e radhës për tu certifikuar, por deri tani ky kurs vjetor nuk është çelur ende.

Sektori i Auditit të Brendshëm ka marrë masa për vazhdimin e trajnimeve të vijueshme profesionale për specialistët e Nj.A.B. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e hartimit të PBA-së për periudhën 2022-2024, rezultoi se nga strukturat e Bashkisë Peqin nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore, përkatësisht:

- Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;
- Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 13. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës të marrë masa që pas miratimit të programit buxhetor afatmesëm të japë opinion për rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës në vazhdimësi do të marrë masa që pas miratimit të programit buxhetor afatmesëm të japë opinion për rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Bashkia Peqin, pas plotësimit të programit buxhetor afatmesëm, do të jap opinion mbi rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2021 rezulton se:

- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor.

Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandim: Bashkia Peqin të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, që mos të sjellë diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi, është dokumentuar procesi i konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Peqin për vitin 2022 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022, ndërsa 3 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar nga Bashkia Peqin për vitin 2022. Kryetari i Bashkisë Peqin në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, Shtojca 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojca 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Peqin të merren masa për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit duke plotësuar të gjitha anekset me të dhënat përkatëse si dhe të dërgojë në institucionet përkatëse këto raporte sipas afateve të përcaktuara. Gjithashtu, të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë janë hartuar raportet 3 mujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe anekseve të tij. **Rekomandimi është zbatuar.**

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura nga dokumentet analitike të Bashkisë Peqin nga fatura të pa likuiduara brenda afatit 60 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i radhës në likuidimin e tyre rezulton se, vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të këtij viti të paraqitet 137,497,700 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", i ndryshuar me Udhëzimin nr.

5/1 datë 21.05.2014, pika 4. Ligji nr. 68/2017 "Përfinancat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në Bashkinë Peqin të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit nga momenti i prerjes së faturës, si dhe të raportoje periodikisht në MFE.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. Është hartuar një plan shlyerje i cili është miratuar në Këshillin Bashkiak.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhura sipas zërave rezultoi se ekzistojnë disa zëra për të cilat Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave nuk ka bërë planifikim për vitin 2022. Përkatësisht, zërat tarifë leje transporti plus shërbime, taksë vendore e regjistrimit të biznesit, tarifë vendore për vërtetime, etj., nuk janë llogaritur në planifikim. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, 13, 14 të ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin të marrë masa që, në planin vjetor të të ardhurave të bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga zërat, tarifë leje transporti plus shërbime, taksë vendore e regjistrimit të biznesit, tarifë vendore për vërtetime, etj., si dhe të ardhurat nga të gjitha taksat/tarifat e tjera të parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 në Bashkinë Peqin niveli i realizimit të të ardhurave është 35%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022";
- Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin është miratuar me VKB-në nr. 64, datë 23.12.2022 "Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Peqin", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1575/1 Prot. datë 09.01.2023";
- VKB nr. 121, datë 29.12.2021, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022". *((Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

9. Gjetje nga auditimi: Mos pasqyrim i saktë në kontabilitetin e institucionit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën 137,497,700 lekë. në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3. urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës së Bashkisë Peqin të marrë masa për sistemimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, për vlerën 137,497,700 lekë, e cila është njohur me vlerën 0 në pasqyrat financiare.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi, me mbylljen e pasqyrave Financiare për vitin 2024. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

10. Gjetje nga auditimi: Mos shlyerje e pagave të punonjësve në vlerën 36,552,054 lekë, për muajt Korrik, Gusht, Shtator dhe Dhjetor të vitit 2022 procedurë kjo e ndjekur në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3, Udhëzimi i MFE-së, nr.2 datë, 06.02.2012, pika101, Kodi i Punës, neni 95, neni 101 pika 283, neni 119 pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës të marrin masa të menjëhershme për shlyerjen e pagave të punonjësve në vlerën 36,552,054 lekë.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, është bërë shlyerja e pagave të punonjësve në vlerën 36,552,054, sipas raportit të dokumentuar me shkresën nr.379, datë 23.02.2024,. **Rekomandimi është zbatuar.**

11. Gjetje nga auditimi: Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare, për vlerën kontabël 23,290,504 lekë, ku nuk janë likuiduar garancitë (llog.466) e punimeve që kanë mbushur afatin kohor në vlerën 3,229,135 lekë, për 5 objekte që Bashkia Peqin nuk i ka marrë në dorëzim, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës në Bashkinë Peqin, të marrin masa për likuidimin e garancive të punimeve, të cilat e kanë mbushur afatin, në vlerën 3,229,135 lekë për 5 objektet.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit publik u konstatua se **në 6 (gjashtë)** procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s’kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Gjithashtu rezulton se disa prej kërkesave të veçanta, në këto procedura si dhe specififikimet teknike nuk janë argumentuar në mënyrë teknike dhe ligjore. Veprimet e mësipërme ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik, uljen e konkurrencës. Veprime e mosveprime që nuk janë në përputhje me *Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, pikat 1 dhe 5, neni 36, pika 4, . Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, nenin 2, neni 12, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2, paragrafi dytë, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika*

3, neni 61, pika 2, paragrafi dytë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave të pa argumentuara, ndaj operatorëve ekonomikë.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin, po punohet që në procedurat e ardhshme të Prokurimeve Publike të mbahet parasysh kërkesat ligjore për zbatimin e këtij rekomandimi, dokumentuar me shkresën nr.1907/2, datë 08.11.2023. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

13. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; për vitin 2021 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht: Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 957 827 leke lekë pa TVSH, procedura duhet të kryheshin tenderim, pasi kanë objekt të njëjtë procedurë; është kryer procedura me objekt “Ndërtim bazamenti Qendra Shëndetësore Shez”, në muajin prill me fond limit në shumën 512,500 lekë pa TVSh, procedura me objekt “Ndërtim bazamenti Qendra Shëndetësore Shez , me fond limit në shumën 783,761 lekë pa TVSh e zhvilluar në muajin shtator, procedura me objekt “Ndërtim i bazamentit Qendra Shëndetësore Karine”, me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh, e zhvilluar në muajin shtator, dhe procedura me objekt “Ndërtim i bazamentit Qendra Shëndetësore Karine)” me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh zhvilluar në muajin mars. *Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 1, Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor Bashkia Peqin, të marrë masa që në planifikimin e regjistrimit të prokurimeve, përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, të shmang copëzimin e fondeve, me qëllim që procedurat e prokurimit të zhvillohen sipas kufijve monetar.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin, po punohet që në procedurat e ardhshme të Prokurimeve Publike të mbahen parasysh kërkesat ligjore për zbatimin e këtij rekomandimi, dokumentuar me shkresën nr.1907/2, datë 08.11.2023. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se **në gjashtë** procedura prokurimi, nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës. Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizimit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 310 prot, datë 08.02.2021. Sipas VKM nr.914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 60, përcaktohet se; “...Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit...”. Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 59, pika 2. Gjithashtu rezultoi se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur punë”. Veprime jo në përputhje me VKM

nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me 59, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrit të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin, po punohet që në procedurat e ardhshme të Prokurimeve Publike të mbahen parasysh kërkesat ligjore për zbatimin e këtij rekomandimi, dokumentuar me shkresën nr.1907/2, datë 08.11.2023. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt furnizim me “Blerje Automjeti për Bashkinë Peqin” me vlerë 3,360,000 lekë me TVSh, rezulton se: Nga titullari i AK, nuk janë marrë masat e duhura për caktimin e personave për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, hartimin e planit për zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e mallrave të furnizuar është në përputhje me ato të kërkuara. Nga komisioni i krijuar për marrjen në dorëzim të automjetit, është mbajtur procesverbali nr. 532/1prot., datë 15.03.2021, në të cilin citohet ndër të tjera se verifikimi i automjetit është kryer pranë një Autoservisi në emër të F K. Me këtë subjekt AK nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktuale apo dokumentacion mbi të cilin komisioni ti drejtohej për të garantuar cilësinë e mallit të kërkuar nëse është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor apo jo. Këtë veprim komisioni e ka kryer pa autorizim nga titullari i AK dhe pa asnjë marrëveshje midis palëve (Autoservisit dhe AK). Pavarësisht se nga Autoservisi është lëshuar një dokument si Çertifikatë e kontrollit teknik të automjetit, në këtë dokument nuk përkthehen të gjitha cilësitë për të cilat janë hartuar specifikimet teknike të mjetit në Dokumentet e Tenderit. Pra marrja në dorëzim e mjetit, nuk është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi pasi nuk është në përputhje me kushtet e kontratës. Gjithashtu nuk është raportuar pranë APP sipas formularit përkatës për ecurinë e zbatimit të kontratës. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për çdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin, po punohet në vijimësi për zbatimin e këtij rekomandimi, dokumentuar me shkresën nr.1907/2, datë 08.11.2023. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjeti për Bashkinë Peqin”, AK nëpërmjet NjP, ka dërguar ftesë për ofertë 5 Operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në tender. Referuar verifikimit të OE të ftuar rezulton se një prej OE të ftuar nuk ka në fushë veprimtarinë e ekstraktit të QKB, objektin e prokurimit dhe konkretisht OE “G G” me objekt Veprimtarie “Tregti me pakice materiale ndërtimi, bojra, artikuj elektroshtëpiake, elektrike, vegla pune, hidraulike, rrjeta teli.” Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së procedurës së prokurimit rezulton se nuk është argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhja e OE të ftuar. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve dhe Njësia e Prokurimit të marrin masat e duhura që, në procedurat e prokurimit “Kërkesë për propozim”, në vijim, të kryejnë verifikimin e OE të cilët do t’u dërgojnë ftesën për ofertë, me qëllim që veprimtaria e tyre në ekstraktin e QKB të jetë në përputhje me objektin e kontratës që do të prokurohet.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e Bashkisë Peqin, po punohet që në procedurat e ardhshme të Prokurimeve Publike të mbahen parasysh kërkesat ligjore për zbatimin e këtij rekomandimi, dokumentuar me shkresën nr.1907/2, datë 08.11.2023. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tre raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë problematika me kartelat e pasurisë së paluajtshme, mangësi në projektet që përbëjnë projektin ndërtimor, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe licencat. Në një rast konstatohet se informacioni i dokumentacionit të aplikimit për leje ndërtimi nuk është i saktë në të gjitha rastet, pasi plani i riveimit nuk është i plotësuar me të gjitha të dhënat e domosdoshme, polica e sigurimit nuk është brenda afatit të vlefshmërisë, informacioni i vendosur në plan-vendosjen e miratuar nuk është i saktë. Gjithashtu, nga auditimi i procedurave të miratimit të kërkesave për pajisje me certifikatë përdorimi, konstatohet se në dy raste, këto certifikata janë miratuar në mungesë të theksuar të dokumentacionit të detyrueshëm, siç janë policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, aktet përkatëse nga UK, OSHEE, PMNZSH, menaxhimi i mbetjeve urbane, kontrata midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, licencat e shoqërive ndërtuese, certifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit energjetic, etj. *Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.111/2018, Neni 17, pika 4 dhe 6, Vendimin nr. 457, datë 29.6.2022, Neni 18 dhe 21. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Nga DPKZHT dhe Bashkia Peqin, të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t’u pajisur me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi, si dhe të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi me mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionin shoqërues të tij. Gjithashtu, DPKZHT të kontrollojë vërtetësinë, saktësinë dhe orgjinalitetin e dokumentacionit të dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, si dhe të shmangë miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, deri në plotësimin e dokumentacionit sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e DPKZHT Bashkisë Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në tre raste nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Nga DPKZHT Peqin të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e DPKZHT Bashkisë Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtyre rekomandimeve. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në asnjë rast, objekti i miratuara me leje ndërtimi nuk është pajisur me vërtetim

për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen. Edhe pse në sistemin elektronik të lejeve nuk është parashikuar dritarja e nevojshme aplikim për pajisje me vërtetim për riskun, DPKZHT nuk ka kërkuar asnjë rast dokumentacionin e parashikuar në vendimin e poshtë-cituar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 1 të VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtitim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”, si dhe në mungesë të dokumentacionit të kërkuar sipas Shtojcës 1 të këtij vendimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: DPKZHT të ndërpresë praktikën e miratimit të lejeve të ndërtimit, për objekte të cilat nuk janë të pajisura me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen. Në çdo rast, DPKZHT të kërkojë dokumentacionin e detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi, deri në krijimin e hapësirës së nevojshme në sistemin elektronik të lejeve për pajisje me vërtetim për riskun.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e DPKZHT Bashkisë Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, më konkretisht për objektin “Leje ndërtimi për kabanon frigoriferik 1 kat”, miratuar me vendim nr. 120, nr. 148 prot; datë 26.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Peqin, me subjekt zhvillues “R” ShPK, me adresë në Bardhas, Peqin, nuk është respektuar kondicioni urban i intensitetit maksimal të lejuar. Për rastin në fjalë, gjatë përlllogaritjes së intensitetit të ndërtimit, si parcela ku mbështetet objekti, janë marrë në konsideratë katër parcela të cilat nuk kanë lidhje fizike me njëra tjetrën, duke zvogëluar në mënyrë fiktive intensitetit e ndërtimit, veprime këto në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 38, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Nga DPKZHT Peqin të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi për objekte të cilat nuk respektojnë të gjitha kondicionet urbane, DPKZHT të verifikojë situatën e parcelave mbi të cilat mbështetet objekti në zhvillim, si dhe në çdo rast të kërkojë mendimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të marrë verifikimin mbi ndërlidhjen e parcelave, kur objekti zhvillohet në më shumë se një pasuri.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e DPKZHT Bashkisë Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, në lejen e ndërtimit të miratuar me vendim nr. 148, nr. 177 prot; datë 24.08.2022 të Kryetarit të Bashkisë Peqin për objektin “Rikonstruksion i ish-repartit ushtarak nr. 5012, në Peqin, Godina 3, 4 dhe sistemimet përreth tyre” me subjekt zhvillues “A” ShPK, me adresë në Karinë, Peqin, lloji i ndërhyrjes që parashikohet të kryhet, nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar. Në këtë rast është aplikuar për leje ndërtimi për rikonstruksion, pa ndryshim funksioni, por në fakt, objekti i rikonstruktuar nuk do të ketë të njëjtin funksion si më parë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 12 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: DPKZHT të marrë masa për të mos miratuar aplikime, për të cilat lloji i ndërhyrjes nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e DPKZHT Bashkisë Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin, u konstatua se për periudhën nën auditim, 01.01.2021 – 31.12.2022, struktura e IMTV është përbërë nga nëntë kryeinspektor dhe inspektor, (aktualisht në marrëdhënie pune janë një kryeinspektor dhe pesë inspektor), por vetëm dy prej tyre plotësojnë kriteret e formimit arsimor. Gjithashtu edhe dy kryeinspektor dhe një inspektor të cilët kanë qenë të punësuar në këtë strukturë, por kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, kanë patur të njëjtën mangësi. Mangësitë e mësipërme nuk japin siguri për garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe janë në kundërshtim me Ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Njësia e Burimeve Njerëzore, të marrin masa që struktura e IMTV-së të përbëhet nga punonjës të cilët të jenë me arsim të lartë në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit, sipas parashikimeve ligjore.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

23. Gjetje nga auditimi: IMTV Bashkia Peqin nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në ligj në lidhje me mbajtjen e akteve përkatëse. IMTV nuk ka mbajtur në asnjë rast proces verbalin e pezullimit të punimeve. Gjithashtu IMTV nuk ka ndërmarrë të gjitha masat për prishjen e objekteve pa leje, pasi IMTV ka detyrimin të kërkojë asistencë nga IKMT për kthimin në gjendjen fillestare të këtyre shkeljeve. IMTV nuk ka kallëzuar penalisht në asnjë rast kundërvajtësit, duku mos përdorur të gjitha masat ndëshkuese dhe shtrënguese për të parandaluar shkelje të tilla. IMTV nuk ka kërkuar në asnjë rast heqje e licencës profesionale për zhvilluesin, subjektin ndërtues, mbikëqyrësin e punimeve ose kolaudatorin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Nga ana e IMTV Bashkia Peqin të merren masa që për çdo rast, të respektohen procedurat sipas parashikimeve ligjore, në varësi të shkeljes së konstatuar, të aplikohen të gjitha masat ndëshkuese ndaj kundërvajtësve, si dhe të kërkohet e gjithë asistencë e nevojshme për ekzekutimin e vendimeve të prishjes.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e IVMT, Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ekzekutimin, kontabilizimin dhe vjeljen e gjobave, konstatohet se nga struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, për periudhën objekt auditimi, janë vendosur 23 gjoba me vlerë 11,500,000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar. Për 14 vendime për gjobë në vlerën 7,000,000 lekë, IMTV i është drejtuar Gjykatës Administrative, duke i kërkuar nxjerrjen e titullit ekzekutiv, nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion që të vërtetojë nxjerrjen e këtij titulli, duke pretenduar se IMTV dhe Bashkia Peqin nuk janë informuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Peqin, mbi vendimet e marra për këto raste, nëse për këto vendime gjykata e ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit. Bashkia Peqin, IMTV, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës nuk kanë përdorur mënyrat e parashikuara në Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, Neni 31, pika 5, për arkëtimin e këtyre masave administrative, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasuri deri në pagimin e gjobës. Në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në Ligjin 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e

po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me IMTV, të marrin masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit, për të bërë të mundur arkëtimin vlerave financiare në gjobat e aplikuara, si dhe përlllogaritjen e kamat-vonesave, sipas afateve dhe kriterëve ligjore.

24.2. Rekomandimi: Nga ana e IMTV Bashkia Peqin, të merren masa për ndëshkimin e kundërvajtësve, në raport të drejtë me llojin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mënyrat e parashikuara në ligj për përlllogaritjen e vlerës së masës administrative në varësi të investimit të kryer pa leje të miratuar ose në shkelje të saj.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e IVMT, Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi.

Nga IMTV, Bashkia Peqin, ka filluar procedurat për arkëtimin e detyrueshëm të gjobave të vendosura, dhe për periudhën Dhjetor 2023 e në vazhdim, është bërë arkëtimi i gjobës ndaj subjektit “B” në vlerën 500,000 lekë për llogari të Bashkisë Peqin.

Për subjektet e tjera që kanë përfunduar afatet e njoftimit dhe ankimimit kanë filluar procedurat e arkëtimin të gjobave nëpërmjet organeve përmbartimore për 7 praktika, dërguar me shkresë zyres përmbartimore z.M.C, me shkresë nr.836; 836/1/2/3/4/5/6 prot, datë 03.05.2024.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura nga IMTV Peqin për periudhën objekt auditimi, u konstatua se kjo strukturë ka hartuar plane mujore të punës vetëm për periudhën nëntor – dhjetor 2022, ndërsa për periudhën tjetër janar – dhjetor 2021 dhe janar - tetor 2022, nuk janë hartuar plane pune mujor, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 1/b/ii. Gjithashtu u konstatua se Kryeinspektori i IMTV nuk ka përgatitur informacion periodik dhe nuk ka raportuar pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Këto raportime duhet të jenë çdo tre muaj, mbi aktivitetin e IMTV, kryesisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm, etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, Neni 5, pika f. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Peqin dhe IMTV të merren masa për të inspektuar territorin dhe garantuar zhvillimin e kontrolluar të tij, duke organizuar punën inspektuese mbi planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori. Gjithashtu, të merren masa për kryerjen e raportimit çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV, pranë IKMT, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional dhe efektivitetit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e IVMT, Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna konstatohet se, Bashkia Peqin ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022, por nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se Bashkia Peqin nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera

nga Kontrolli i Lartë i Shtetit..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raportin rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij". (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Peqin nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:

- Nga 15 masa organizative janë pranuar 15 masa nga të cilat është realizuar 1 masë, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 11 masa.

Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.

Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Peqin, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Peqin nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm, për të cilën kjo masë rezulton e pa zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peqin të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi si vijon:

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

- **Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për rizbatim:**

1.1 Rekomandimi: Bashkia Peqin, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masat në mënyrë që:

- Temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.

- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për kontrollin e brendshëm, i cili ndihmon në organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për arritjen e objektivave, duke bërë të mundur realizimin dhe përmbushjen e objektivave duke siguruar minimizimin e risqeve.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

2.1 Rekomandimi: Bashkia Peqin duhet të marrë masa në mënyrë që Njësia e Auditit të Brendshëm, të funksionojë me punonjës të certifikuar dhe kualifikuar, kërkesë e cila bazohet në kriteret për krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

3.1 Rekomandimi: Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës të marrë masa që pas miratimit të programit buxhetor afatmesëm të japë opinion për rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe PBA-ja të publikohet brenda afatit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

4.1 Rekomandimi: Bashkia Peqin të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Peqin të merren masa për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit duke plotësuar të gjitha anekset me të dhënat përkatëse si dhe të dërgojë në institucionet përkatëse këto raporte sipas afateve të përcaktuara. Gjithashtu, të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

6.1 Rekomandim: Bashkia Peqin të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe të raportojë periodikisht në MFE.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Sektori i Buxhetit të hartojnë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojnë me rigorozitet radhën e regjistrimit të vendimeve në Bashki kur të kryejnë likuidimet.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin të marrë masa që, në planin vjetor të të ardhurave të bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga zërat, taksë vendore e përkohshme, tarifë e regjistrimit të veprimtarive të ndryshme, tarifë për leje zhvillimi, taksë vendore për mirëmbajtje, të ardhura nga qira e tokës bujqësore, të ardhura nga qira troje, tarifë licence radiotelevizive, si dhe të ardhurat nga të gjitha taksat/tarifat e tjera të parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave të angazhohet në marrjen e masave në terren gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Peqin, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Peqin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë 466 “Kreditorë dhe mjete në ruajtje” si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë, të cilave tashmë ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

13.1 Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është zbatuar.**

14.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Peqin të merren masa për:

- Të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 190,000 lekë të konsideruar dëm ekonomik, nga 9 subjekte persona fizik;
- Të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 650,000 lekë, nga 5 subjekte ndërtimi;
- Arkëtimin e vlerës prej 261,528 lekë pa TVSh nga BOE “B” ShPK & “Pesë V” ShPK;
- Arkëtimin e vlerës prej 744,984 lekë pa TVSh nga BOE “B” ShPK & “P.V” ShPK & “Z” ShPK;
- Arkëtimin e vlerës prej 137,300 lekë pa TVSh nga BOE “L” ShPK & “B” ShPK & “G.P.G” ShPK;
- Lidhjen e kontratave të qirasë me personat të cilët kanë zaptuar tokat bujqësore dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës 4,941,853 lekë.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. Nga shoqëria L ShPK, janë arkëtuar vlerat 102.000 lekë dhe 55.000 lekë sipas faturës për arkëtim nr.299 dhe 300 datë 06.11.2023. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

15.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Peqin të merren masa për:

- Kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave të bizneseve dhe të familjarëve, raportimin në Drejtorinë e Financës me qëllim pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve, në vlerën 46,332 mijë lekë;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimin të detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë. Gjithashtu, të merren masa për aplikimin

e programe elektronike për kontrollin dhe menaxhimin e veprimeve financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale;

- Shqyrtimin e të dhënave teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit përpara fillimit të punimeve;

- NJAB dhe Titullari i institucionit të nisin procedurën e certifikimit për të gjithë strukturën e NJAB;

- Shndërrimin e vendimeve për kundërvajtjet administrative në titull ekzekutiv. Sektori Juridik në bashkëpunim me IMTV, të marrin masa për arkëtimin i vlerës prej 3,500,000 lekë nga 7 persona;

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

- **Mbi përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike:**

- Analizimin e efektit ekonomik të vlerës ekonomike prej 7,332,397 lekë pa TVSh në vit kalendarik që OE fitues “V. G” ShPK, ka përfituar si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të fondit limit, mos përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Ndarja e sistemimi i mbeturinave në vend depozitim e kompostim” me vlerë ekonomike vjetore 4,560,422 lekë pa TVSh dhe përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Mirëmbajtje e rrugëve kryesore” me vlerë ekonomike vjetore 3,979,555 lekë pa TVSh;

- Analizimin e efektit që ka shkaktuar vendosja e kërkesave/kritereve të panevojshme që nuk mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor për realizimin e shërbimit;

- Analizimin e performancës financiare të Shoqërisë “K.F.Sh” ShA dhe mbi këtë bazë, të përcaktojë për të ardhmen vlerën dhe destinacionin e fondeve për këtë subjekt.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Peqin të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të angazhohet në procesin e planifikimit të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, të dyja drejtoritë, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 446 debitorë në vlerën 19,299,928 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Nga strukturat e Bashkisë Peqin të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **5,982,624 lekë** nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira, si dhe të raportojnë periodikisht në Drejtorinë e Financës detyrimet që kanë qiramarrësit.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **8,202,497 lekë** për 269 biznese;

- **7,616,000 lekë** nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;

- **9,640,000 lekë** për taksën e tokës bujqësore për **4820 familjeve;**

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B” SHPK, “J. P” SHPK, “K” SHPK, “O” SHPK, “A. H 2013” SHPK dhe “O ” SHPK të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore **200,000 lekë secili**. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

5.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjrobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **7,500,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, në vijimësi po punohet për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

B. Masa për shpërblim dëmi.

1. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në terren për zbatimin e kontratës me objekt “ Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit fshati Bicaj dhe Caushaj” me vlerë kontrate në shumën 114,345,663 lekë me TVSh, me **BOE** kontraktues “BB” SHPK & “P. V” SHPK & “B-N” SHPK & “D C” SHPK, u konstatuan se: Zëri me nr.3.352 “Mbushje e ngjeshje me gurë kave”, me sasi 1057 m³ dhe vlerë 2,238,726 lekë, nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri me nr.3.212/d Shtresë stabilizanti t=20cm me sasi 5533 m³ dhe vlerë 4,614,522 lekë, nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri me nr.3.222/2 Shtresë binder me granil gur kave 6cm me makineri me sasi 1476 m³ dhe vlerë 2,637,612 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri me nr.Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave 4cm me makineri me sasi 1476 m³ dhe vlerë 11,969,364 lekë, nuk ishte realizuar ende në terren.

Në total për rubrikën “Sistemim i sheshit të objekteve ne vendburim” të situacionit nr.11 ka vlerën 11,696,364 lekë.

Për rubrikën “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” nga kontrolli në terren u konstatua se:

Zëri i punës 3.352 Mbushje ngjeshje me gur kave me sasi 482 m³ dhe vlerë 1,020,876 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.

Shtresë stabilizanti t=20cm me sasi 1190 m³ dhe vlerë 992,460 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri i punës Shtresë binderi me granil e gur kave 6 cm me makineri me sasi 1190 m³ dhe vlerë 2,126,530 lekë nuk ishte realizuar edhe në terren.

Zëri i punës 3.226/1 Shtresë asfalto betoni me granil e gur kave 4 cm me makineri me sasi 1190 m³ dhe vlerë 1,769,530 lekë.

Në total për rubrikën “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” sipas situacionit 11 ka vlerën 5,909,396 lekë.

Zëri i punës “Mbushje me zhavorr pas mureve” në titullin “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” me sasi 750 m³ dhe vlerë 885,000 lekë nuk ishte realizuar ende në terren. Duke u bazuar situacionit nr.11 i cili nuk është situacioni përfundimtar dhe verifikimin në terren për punimet e kryera shuma **18,763,760** lekë është vlera e punimeve ende të pakryera. Në lidhje me këto konstatime të grupit të auditimit, nga subjekti kontraktor por edhe nga Bashkia Peqin, pas përfundimit të punës audituese në subjekt, janë paraqitur observacione dhe dokumentacion shtesë nga ai i paraqitur gjatë fazës së auditimit në terren. Në lidhje me këto pretendime grupi i auditimit nuk mund të dalë në përfundime nëse volumet e zërave të punimeve

të mësipërme janë në përputhje si nga ana sasiore dhe ajo cilësore me projektin e miratuar pasi e ka përfunduar verifikimin dhe auditimin në terren. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, pika 3 dhe kontratën e lidhur midis sipërmarrësit dhe investitorit me Nr.704 Prot, datë 19.04.2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Për arsye se gjatë vazës së verifikimit në teren të investimit nga ana e grupit të auditimit, punimet nuk kanë qenë tërësisht të përfunduara, nga Bashkia Peqin të ngrihet një grup pune me inxhinierë specialistë të fushës të cilët të kryejnë verifikimet e punimeve, referuar konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit të KLSH. Bazuar në verifikimet e kryera të bëhen rakordimet në situacionin përfundimtar. Grupi i punës të mbajë një proces-verbal për atë çfarë do konstatojë në terren, të cilin t'ja paraqes për veprime të mëtejshme Kryetarit të Bashkisë. Për ato zëra punimesh të cilat do të konstatohen të pa kryera, të kërkohet prej kontraktorit realizimi i tyre dhe, në rast mospranimi, të kërkohet shlyerja e dëmit në vlerën e punimeve të pa kryera të cilin ta vendosë në dispozicion grupit të auditimit radhës nga KLSH që do jetë në vijim në Bashkinë Peqin.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, nuk janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në terren për dosjen me objekt "Ndërtimi i pritave lumore dhe përforcimi i këmbëve të urës në shtratin e Lumit Shkumbin" për të cilin është lidhur kontrata nr. 1613, datë 13.10.2022, janë situacionuar 68 m³ gabione me rrjetë teli 1x1x2 m dhe 34 m³ gabione me rrjetë teli 1x1x1m. Në total janë 102 m³ Sipas librezës së masave gjatësia e gabionit është 17 metër. Gjatësia faktike e matur në terren është 15.3 metër linear. Diferenca prej 1.7 metër linear gabion me rrjetë teli, u konstatua e pa vendosur nga kontraktori, e cila e konvertuar në vlera financiare është **102,000 lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për arkëtimin e vlerës 102,000 lekë nga BOE "L" ShPK, "V.K" dhe "BN" ShPK., për mos vendosjen në punimet e kontratës me objekt "Ndërtimi i pritave lumore dhe përforcimi i këmbëve të urës në shtratin e Lumit Shkumbin", të gabionit me rrjetë teli në gjatësinë 1.7 m linear.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi. Është arkëtuar vlera financiare 102,000 lekë nga subjekti "L" ShPK sipas faturës për arkëtim të datës 06.11.2023. **Rekomandimi është zbatuar.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e punimeve të kontratës me objekt "Ndërtimi dhe sistemimi me gabion i përroit të Rrushtës njësia administrative Karinë", u konstatua se: volumi total i betonit i cili duhet të realizohet është 99 m³ ndërkohë që në fatk është realizuar sasia prej 93.5 m³. Diferenca në volum prej 99 m³-93.5 m³= 5.5 m³ e cila me çmimin për m³ në shumën 10,000 lekë/m³, punë e cila nuk është realizuar, ka sjellë për pasojë dëm ekonomik në vlerën 55,000. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për arkëtimin e vlerës 55,000 lekë nga BOE "L ShPK" dhe "M ShPK", për mos realizimin në teren të sasisë së betonit prej 5.5 m³, në kontratën me objekt "Ndërtimi dhe sistemimi me gabion i përroit të Rrushtës njësia administrative Karinë".

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi. Është arkëtuar vlera financiare 55,000 lekë nga subjekti "L" ShPK sipas faturës për arkëtim të datës 06.11.2023. **Rekomandimi është zbatuar.**

D. Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Peqin për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 1,163,505 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore. Vlera e mësipërme, i përket vendimeve gjyqësore me objekt "dëmshpërblim page" për largime nga puna të punonjësve dhe vlerë përmbartimore.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, ndihmon në evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Drejtoria/Spektori Juridik, të analizojnë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore, si dhe të dalin përgjegjësitë administrative. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Bashkia Peqin, titullari i Bashkisë ka marrë në konsideratë rekomandimin dhe janë duke analizuar të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 122 objekte me vlerë totale të detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, në vlerën 7,526,463 lekë. Rezulton se kanë paguar detyrimet 34 qytetarë me vlerë 1,600,529 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 88 prej tyre në vlerën 5,925,934 lekë.

Gjithashtu për periudhën përpara vitit 2022, për këtë taksë u konstatua se janë debitorë 386 qytetarë për vlerën 15,910,147 lekë. Në total vlera e detyrimeve ndaj Bashkisë Peqin, nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet nga 474 objekte të legalizuara, rezulton në vlerën 21,836,081 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27. Ligjit nr. 95/2018 "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c. Ligjit nr. 98/2020 "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c". VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5. VKB nr. 120, datë 29.12.2021 "Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Peqin të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të angazhohet në procesin e planifikimit të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, të dyja drejtoritë, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në

infrastrukturë për **474 debitorë në vlerën 21,836,081 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Peqin të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Bashkia Peqin, ka vijuar puna për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 474 debitorë për vlerën 21,836,081 lekë. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga 5 subjekte që kanë kontratë qiraje në vitin 2022 rezulton se vetëm qiramarrësi "A M" për vlerën 116,100 lekë nuk kanë paguar detyrimet e kontratës. Detyrimi që subjekti ka ndaj Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën është 116,100 lekë, dhe detyrime progresive deri në fund të vitit 2022 janë 1615 akt marrëveshje për dhënie sipërfaqesh toke me qira familjeve në pesë njësitë e saj administrative. Nga këto akt marrëveshje priten që të arkëtohen të ardhura vjetore në vlerën 5,982,624 lekë. Nga auditimi i pagesave të qirave për këto akt marrëveshje rezultoi se, për vitin 2022 nuk është paguar asnjë detyrim dhe mbetet për t'u paguar detyrimi në vlerën 5,982,624 lekë. Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin më datë 31.12.2022 si rezultat i mos pagesës së detyrimit për sipërfaqet e marra me qira janë në vlerën totale 5,982,624 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.
- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar.
- VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".
- VKB nr. 120 datë 29.12.2021 "Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **5,982,624 lekë** nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë ka vijuar puna për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 5,982,624 lekë. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

4. Gjetje nga auditimi: Vlera e detyrimeve ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifave vendore, e krijuar vetëm gjatë vitit 2022 është 16,882,981 lekë, nga e cila vlera 9,008,131 lekë i përket detyrimeve nga debitorët private dhe 7,874,850 lekë detyrimeve nga debitorët e kategorisë familjare.

Vlera e detyrimeve progresive ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifave vendore, në datën 31.12.2022 është 30,568,308 lekë, nga e cila vlera prej 11,590,558 lekë është krijuar nga 238 debitorë privat, ndërsa vlera 18,977,750 lekë nga debitorët familjar (përfshirë edhe taksën e tokës bujqësore në vlerën 9,873,750 lekë nga 4 930 familjeve)

Vlera prej 30,568,308 lekë konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar.

Për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 4 930 familjeve me vlerë të detyrimit 9,873,750 lekë, ndërsa vlera progresive deri me 31.12.2022, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Peqin është në vlerën 10,200,000 lekë.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezultojnë se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, nuk janë marrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e ligjit. Këto veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

- 11,590,558 lekë për 238 biznese;

- 9,104,000 lekë nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;

- 10,200,000 lekë për taksën e tokës bujqësore;

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Peqin, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Nga verifikimi i zbatimit rezultojnë se: Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore për periudhën Nëntor 2023 e në vijimësi janë arkëtuar detyrimet e papambetura;

- 5,384,667 lekë për 104 subjekte biznes i vogël;

- 796,770 lekë për 6 subjekte biznes i madh;

- 4,335,050 lekë nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet (1445 familje);

- 3,25,860 lekë për taksën e tokës bujqësore për 1625 fermerë;

Në total nga vlera e rekomanduar prej 30,894 mijë lekë është arkëtuar vlera 10,842 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 20,052 mijë lekë. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Peqin u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 15 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 15 masa për “Prishje të objekteve të kundërligjshëm” si dhe 15 masa “Dënim me gjobë”. Nuk ka paguar asnjë subjekt vullnetarisht me vlerë totale të gjobave prej 7,500,000 lekë të vendosura për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5, Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **7,500,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda

afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Nga ana e IVMT, Bashkia Peqin kanë filluar procedurat për arkëtimin e detyrueshëm të gjobave të vendosura, dhe për periudhën Dhjetor 2023 e në vazhdim, është bërë arkëtimi i gjobës ndaj subjektit “B” në vlerën 500,000 lekë për llogari të Bashkisë Peqin. Për subjektet e tjera që kanë përfunduar afatet e njoftimit dhe ankimimit kanë filluar procedurat e arkëtimit të gjobave nëpërmjet organeve përmbartimore për 7 praktika. Në përfundim nga vlera 7,500 miqë lekë është arkëtuar vlera 500 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 7,000 mijë lekë. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Peqin nga 7 subjekte që kanë aktivitet tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, 2 subjekte (“B” SHPK dhe “J. P” SHPK) nuk janë pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit, që sjellin të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin në vlerën 400,000 lekë. Subjekti “D O” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 07.10.2021-06.10.2022, për periudhën 07.10.2022-31.12.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 153,340 lekë. Subjekti “K” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 11.10.2022-10.10.2023, për periudhën 01.01.2022-10.10.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 155,550 lekë. Subjekti “O ” SHPK për të dy pikat e aktivitetit të mësipërm, është pajisur me autorizim nga data 10.06.2022-09.06.2023 dhe 10.06.2022-09.06.2027, për periudhën 01.01.2022-09.06.2022 të dy pikat janë të pa pajisura me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 5 muaj e në vlerën 176,666 lekë. Ushtrimi i aktivitetit nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse të pa pajisur me autorizim/licencën përkatëse ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën 885,556 lekë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20. VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B” SHPK, “J. P” SHPK, “K” SHPK, “O” SHPK, “D.O” SHPK, “S.G” ShPK dhe “O ” SHPK të plotësojnë kriteret e nevojshme e më pas të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore 200,000 lekë secili. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, Bashkia Peqin, nuk ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi dhe ndaj këtyre subjekteve deri në këtë periudhë nuk rezulton të jetë arkëtuar ndonjë vlerë. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

E. Masa disiplinore.

E.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe

të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Peqin, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

A. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për;

1. **Zj. G.N**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve njerëzore dhe TIK për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në një rast për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe një rast për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit;

2. **Zj.XH.S**, me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në dy raste për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe dy raste për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, gjithashtu në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, dy raste, dhe certifikatave të përdorimit të miratuara, dy raste;

3. **Z.E.H**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në dy raste për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe dy raste për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, gjithashtu në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, tre raste, dhe certifikatave të përdorimit të miratuara, dy raste;

4. **Z.A.D**, me detyrë Specialiste mjedisi, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në një rast për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe një rast për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, gjithashtu në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, tre raste, dhe certifikatave të përdorimit të miratuara, dy raste;

5. **Zj.XH.L**, me detyrë përgjegjëse e Arkës në Drejtorinë e financës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 2 procedura, në një rast për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe një rast për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit;

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Kryetari i Bashkisë Peqin, në cilësinë e eprorit direkt, mbasi shqyrtoi rekomandimin e KLSH-së, ka ngritur komisionin disiplinor, dhe janë dhënë masat disiplinore si më poshtë;

A.1 “Verejtje me paralajmërim” për nëpunësit;

1. **Zj.G.N**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve njerëzore dhe TIK

2. **Zj. XH.S** me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve,;

3. **Z.E.H**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës;

4. **Z.A.D**, me detyrë Specialiste mjedisi;

5. **Zj.XH.L**, me detyrë përgjegjëse e Arkës në Drejtorinë e financës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në;

Rekomandimi është zbatuar.

- Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 12 “Masa Disiplinore”, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Peqin, që për shkeljet e paraqitura në Raportin

Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. “Vërejtje” për;

1. **Z. A.K** me pozicion specialist në Drejtorinë e financës, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të automjetit;
2. **Zj. V.M**, me specialist finance, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të automjetit;
3. **Z. SH.M**, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të automjetit;
4. **Znj. B.T** me detyrë specialiste ndërtimi pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, një rast.
5. **Z. A.Ç**, me detyrë specialist ndërtimi pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, një rast.
6. **Z. K.S**, me detyrë kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në lidhje me mos ndjekjen të gjitha procedurat dhe mosmarrjen e të gjitha masave për ndëshkimin e kundërvajtësve, sipas parashikimeve ligjore, për mosmarrjen e të gjitha masat për vjeljen e gjobave, si dhe përlllogaritjen e kamat-vonesave, sipas parashikimeve ligjore.

Nga verifikimi i zbatimit rezulton se: Kryetari i Bashkisë Peqin, në cilësinë e eprorit direkt, janë dhënë masat disiplinore si më poshtë; **“Vërejtje”** për punonjësit;

1. Z. A.K;
2. Zj. V. M.;
3. Z. Sh. M;
4. Znj. B.T;

b. “Vërejtje me paralajmërim” për:

1. **Z. J.S**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, dy raste, dhe çertifikatave të përdorimit të miratuara, një rast;

Rekomandimi është zbatuar

III. GJETJE REKOMANDIME.

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, është pjesërisht efektiv pasi mungojnë disa elementë të komponentëve të MFK-së, kryesisht në çështjet:

Për vitin 2023 nuk është hartuar plan-veprimi për MFK si dhe mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Në Bashkinë Peqin nuk është caktuar koordinatori i riskut, megjithëse është hartuar regjistri dhe strategjia e riskut.

Bashkia Peqin nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

Është konstatuar se në faqen web të Bashkisë Peqin janë paraqitur informacione si buxheti i bashkisë, tarifat dhe taksat vendore, por mungon raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2023. Në Bashkinë Peqin mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

Veprimet apo mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peqin, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrit të Riskut, (iii) të ngrihet struktura e kordinatorit dhe grupit të manexhimit të riskut, (iv) Të garantohet se njoftimi/ shpallja e vendeve të lira të punës, të dërgohet zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Struktura e auditimit të brendshëm si pjesë përbërëse e strukturës së bashkisë është miratuar me VKB nr.63 prot, date 23.12.2022 dhe është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1572/1 prot, datë 10.01.2023 me përbërje 3 (tre) punonjës, nga të cilët 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) specialiste auditimi. Konstatohet se njëri nga audituesit nuk është i pajisur me certifikatë auditusi (z. A.Gj) i cili që nga data 01.12.2022 ka zëvendësuar në këtë detyre z. B.K, është i pa certifikuar.

Gjatë vitit 2023, NjAB ka kryer 9 misione auditimi kundrejt 9 misione të programuara duke realizuar në numër 100 % të planit vjetor.

Nga të dhënat konstatohet se nga NJA nuk planifikohen zona me risk, siç mund të jenë: Drejtoria e taksave, Drejtoria e PZHKT, Sektori i procedurave të prokurimit, sektori i financës etj., sektorë të cilat do i shërbenin titullarit për njohjen më mirë të arkëtimit dhe përdorimit të të ardhurave në interes të komunitetit.

Verime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10; neni 14, pika b; VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, neni 3, pika 3; Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Peqin, të marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pagesave, etj., në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, si dhe plotësimin me certifikatë auditit të punonjësit të pacertifikuar.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se shpenzimet e buxhetit të vitit 2023, nga 986,181 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 823,744 mijë lekë ose në masën 83 %, Pagat (600) nga 260,112 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 224,963 mijë lekë, ose 86%, Sigurime shoq. (601) nga 36,331 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 34,330 mijë lekë, ose 94%, shpenzimeve operative (602), nga 151,941 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 98,319

mijë lekë, ose 65% dhe shpenzimeve për investime (230-231), nga 123,602 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 69,721 mijë lekë ose 56%. Konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative dhe investime, të cilat janë zërat më kryesor të buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezultojnë se realizimi i tyre është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky mos realizim vjen si rezultat i mos realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore që nga 173,167 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 86,274 mijë lekë ose 50%, veprim jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 19-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Bashkia Peqin, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxheteve paraardhëse me qëllimin që programimet e shpenzimeve buxhetore, të jenë sa më të argumentuar. Shpërndarja e fondeve buxhetore, planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit të bëhet mbi baza reale bazuar në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, me qëllim përdorimin me efikasitet të burimeve financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykatë të raportuara në MFE në fund të vitit me shkresën nr.286, datë 08.02.2024, janë për vlerën 74,300,773 lekë (*shpenzime korrente në vlerën 43,663,779 lekë, shpenzime kapitale në vlerën 11,340,021 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 19,296,973 lekë*), ku n raport me shpenzimet e kryera zënë 14,2% të tyre. Të krahasuara me detyrimet e pasqyruara në bilanc në llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” gjithsej në vlerën 94,427,632 lekë rezultojnë se janë pasqyruar më shumë në bilanc për vlerën 20,126,859 lekë, për faktin se në detyrimet e raportuara në MFE nuk janë përfshirë faturat të cilat nuk kanë mbushur afatin 60 ditor për likuidim. Detyrimet e pa papaguara gjithsej në vlerën 74,300,773 lekë nga mungesa e fondeve kryesisht nga të ardhurat veta të cilat për vitin 2023 nuk janë realizuar në vlerën 86,892,595 lekë. Gjithashtu për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë bërë likuidimet në kohë, duke krijuar efekt në likuidimin e shpenzimeve përmbare për në vlerën 2,063,974 lekë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91 dhe pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 19-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masat për rritjen e të ardhurave, duke u ndjekur periodikisht nga personat përgjegjës me qëllim që Këshilli Bashkiak të jetë në gjendje të kontrollojë dhe monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës financiare të Bashkisë. Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

4.2.Rekomandimi: Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që ekzekutimi të

bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbaruesit gjyqësor për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbarimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se janë kryer inventarët fizik për llogaritë 31 “Materiale”, 32 “Inventarë i imët”, 214 “Instalime teknike Makineri pajisje”, 215 “Mjete transporti”, 214 “Instalime teknike Makineri pajisje” dhe 218 “Inventarë ekonomik”, ndërsa për llogaritë e tjera të Aktiveve Afatgjata Materiale nuk janë kryer inventarë fizik, si rrjedhojë pasqyrat financiare përmbajnë vetëm vlerat kontabël të tyre, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogarive në fund të vitit, veprime në shkëlqje të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III, pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa të kryej inventarin fizik për llogaritë e Aktiveve Afatgjata Materiale në fund të periudhës me qëllim krahasimin e gjendjes kontabël me gjendjen fizike dhe për diferencat e konstatuara të bëjë sistemimet në kontabilitet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesat e konstatuara.

Brenda periudhës 31.12.2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 37,981,888 lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se në kredi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve për vlerën 6,151,138 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Peqin, të kontabilizojë vlerën prej 6,151,138 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për saktësimin dhe arkëtimin e debitorëve, në vlerën 37,981,888 lekë.

Brenda periudhës 31.12.2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “Studime dhe projekte”, sipas kostos historike në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 18,805,112 lekë, llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” në vlerën prej 641,555,117 lekë dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 2,775,152,359 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të këtyre llogarive konstatohet se, për llogarinë 202 “Studime dhe projekte”, nuk është zbritur vlera për Projektin “Studim, projektim për rikonstruksionin e ujësjellësit Trash Karthën” në vlerën 9,708,000 lekë, llogarinë 212 “Ndërtesa konstruksione” nuk është zbritur vlera për 2 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 3,821,874 lekë (*Depo uji dhe godinë në vlerën 2,321,874 lekë dhe Pusi Fatishe në vlerën 1,500,000 lekë*) dhe llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” nuk është zbritur vlera për 33 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 576,162,053 lekë, që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë

të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” që duhej transferuar në Ujësjellës Kanalizime Peqin, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 sipas të dhënave të pasqyrës Aneks nr. 3/8, bashkëlidhur (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peqin, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” sha për 36 artikujve, pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 589,691,927 lekë.

Brenda periudhës 31.12.2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga 208 objekte inventari të AAM me kosto historike në vlerën 3,432,327,823 lekë, Bashkia Peqin nuk posedon titull pronësie. Gjithashtu vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Peqin, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*” për 4 objekte shkolla variojnë nga 5,000 lekë deri në 10,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2, me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Bashkia Peqin, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve me vlerat që variojnë nga 5,000 lekë deri në 10,000 lekë buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, është pasqyruar në vlerën 102,942,710 lekë. Nga auditimi ka rezultuar se janë përfshirë në këtë llogari si detyrime të pa likuiduara vlera prej 37,981,888 lekë, që i përkasin debitorëve për taksa e tarifa vendore, për të cilat duhet të pasqyroheshin në llogarinë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*”, duke sjellë një shtesë dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve, veprime në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 31-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të bëjë sistemimet në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, duke zbritur vlerën prej 37,981,888 lekë, që i përkasin debitorëve për taksa e tarifa vendore.

Brenda periudhës 31.12.2024

10. Gjetje nga auditimi: Në total, nga 246 pasuri që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Peqin (pa përfshirë ish-komunat), vetëm 14 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Për katër ish-komuna, Gjocaj, Përparim, Pajovë, Shezë nuk ka Vendim të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës përfundimtare të pronave. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Peqin nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Si pasojë, inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Peqin nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore.

Nga 20 prona, vetëm 8 prona kanë certifikatë pronësie ndërsa 13 pasuri janë me vërtetime hipotekore, çka nënkupton se për to nuk ka kartelë pasurie në regjistrat publike dhe se nuk është aplikuar në ASHK për kalimin nga sistemi i vjetër hipotekor në sistemin e ri të certifikimit, për zona kadastrale ku ka mbaruar procesi i regjistrimit fillestar.

Veprimet e mësipërme nuk janë më përputhje me ligjin nr. nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa që të krijojë bazën e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për të aplikuar në ASHK për kalimin në sistemin e regjistrimit për 13 pasuri që janë me vërtetime hipotekore, me qëllim certifikimin e tyre dhe hapjen e kartelave në emër të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ka ndryshime në sipërfaqe mes dokumenteve të pronësisë dhe inventarit të pasurive të bashkisë si dhe mungesë të marrëdhënieve me truallin për objekte të ndërhuara me investime, konkretisht si mëposhtë:

-Në lidhje me pronat që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik, në listën e inventarit rezulton vetëm një qendër shëndetësore me numër rendor 163, nr. 3/12/2 pasurie e llojit truall +ndërtesë, me sipërfaqe 1440 m² truall dhe 1440 m² ndërtesë, e cila nuk është e regjistruar në ASHK. Dy qendrat shëndetësore, përkatësisht me nr.14/136 dhe 13/179, për të cilat bashkia Peqin disponon dokumente pronësie, vërtetim hipotekor, janë ndërtuar me leje ndërtimi dhe nuk rezultojnë se kanë marrëdhënie me truallin.

-Sa i përket Pallatit të Kulturës u konstatua se në total Bashkia Peqin disponon vërtetime hipotekore për sipërfaqe totale 2504 m² truall dhe 1266 m² ndërtesë ndërkohë që sipas inventarit përfundimtar, pasuritë e lidhura me objektin Pallati i Kulturës kanë një sipërfaqe totale 4578m² truall, ose 2074 m² truall më pak sesa inventari (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1.Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për të hartuar plan rilevimi mbi saktësimin e sipërfaqeve të pasurive për të cilat disponon dokumente pronësie si dhe të kërkojë nga Zyra Vendore e ASHK Peqin informacion mbi statusin juridik të truallit të objekteve me funksion qendër shëndetësore.

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës për mirëadministrativitetin e pronave në Bashkinë Peqin, rezulton se ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme. Ndonëse me urdhrin nr.74 datë 07.03.2024 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar ngritja e një strukture të posaçme për përditësimin e pronave, ky sektor nuk është reflektuar në organigramën bashkisë, por vijon të jetë me një specialist. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peqin në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme, pjesë e organikës së brendshme, për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në funksion të përditësimit të inventarit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik (evidentim në terren) të gjendjes së pronës. Në veçanti, të përcaktojë si prioritet regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shërbimeve arsimore, si shkolla dhe çerdhe.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, Bashkia e Peqinit nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonominë pyjore dhe nuk ka regjistruar nga 162 ngastra asnjë pasuri në regjistrat kadastralë. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim ligjin nr.57/2020 “Për pyjet” dhe me pikën 66 të VKM nr.443/2016 dhe VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullësor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për të planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit si dhe regjistrimin e sipërfaqeve pyjore/kullësore në kadastrë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve, rezulton se:

Nga Bashkia Peqin, është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH -së, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet urdhrin të brendshëm me Nr.428 prot, datë 08.11.2023, dërguar pranë KLSH me shkresë Nr. 1907/2 Prot, datë 08.11.2023.

Ndërsa në lidhje me afatin 6 mujorë, ende nuk është plotësuar për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në total në Bashkinë Peqin janë rekomanduar gjithsej **52 masa me vlerë 87,495 mijë lekë**, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 20 masa me vlerë 157 mijë lekë, janë në proces zbatimi 30 masa me vlerë të mbetur 51,533 mijë lekë (*pasi vlera 15,842 mijë lekë është arkëtuar nga vlera totale*) dhe **nuk është zbatuar 2 masë me vlerë 19,963 mijë lekë, e detajuar:**

a- Janë rekomanduar gjithsej **27 masa organizative**, të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa dhe janë në proces zbatimi 25 masa;

b- Janë rekomanduar **3 masa shpërblim dëmi me vlerë 18,920 mijë lekë** të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa me vlerë 157 mijë lekë dhe nuk është zbatuar **një masa me vlerë 18,763 mijë lekë**;

c- Janë rekomanduar gjithsej **6 masa mos efektivitet me vlerë 68,575 mijë lekë**, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 51,533 mijë lekë (pasi vlera 15,842 mijë lekë është arkëtuar) dhe **nuk është zbatuar një masa me vlerë 1,200 mijë lekë**;

d- Në lidhje me masat disiplinore nga **15 masa**, rezulton se janë pranuar dhe zbatuar 15 masa;

Në lidhje me masat e rikërkua rezulton se janë rikëruar 15 masa me vlerë 49,799 mijë lekë, nga ku 10 masa janë zbatuar dhe 10 masa janë në proces zbatimi për vlerën 49,799 mijë lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 48-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa për shpërblim dëmi.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për arkëtimin e vlerës **18,763,760** lekë nga BOE kontraktues “B.B” SHPK & “P.V” SHPK & “B-N” SHPK & “D.Co” SHPK, për arsye se gjatë vazës së verifikimit në teren të investimit nga ana e grupit të auditimit, punimet nuk kanë qenë tërësisht të përfunduara, nga Bashkia Peqin të ngrihet një grup pune me inxhinierë specialistë të fushës të cilët të kryejnë verifikimet e punimeve, referuar konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit të KLSH. Bazuar në verifikimet e kryera të bëhen rakordimet në situacionin përfundimtar. Grupi i punës të mbajë një proces-verbal për atë çfarë do konstatojë në terren, të cilin t’ja paraqes për veprime të mëtejshme Kryetarit të Bashkisë. Për ato zëra punimesh të cilat do të konstatohen të pa kryera, të kërkohet prej kontraktorit realizimi i tyre dhe, në rast mospranimi, të kërkohet shlyerja e dëmit në vlerën e punimeve të pa kryera të cilin ta vendosë në dispozicion grupit të auditimit radhës nga KLSH që do jetë në vijim në Bashkinë Peqin.

B. Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B” SHPK, “J. P” SHPK, “K” SHPK, “O” SHPK, “DO” SHPK, “S G” ShPK dhe “O” SHPK të plotësojnë kriteret e nevojshme e më pas të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore 200,000 lekë secili. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve informale dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Aluizni Elbasan janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Elbasan. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **132 persona me vlerë 6,151,138 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Peqin.

Nga Drejtoria e PZHKT Bashkia Peqin, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 23,447,723 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh”., të dhënat sipas pasqyrës Aneks 2/4 bashkëlidhur RPA (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 26-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHKT Bashkia Peqin, të marrë masa që me shpresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e taksës së llogaritur, si dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për **132 persona me vlerë 6,151,138 lekë**, sipas pasqyrës Aneks 2/4 bashkëlidhur RPA.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Peqin për periudhën e vitit 2023 nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, përsa i përket arkëtimin të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Peqin, konkretisht të Kapitullit II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe

Sipas të dhënave nga Drejtoria e të Ardhurave, në territorin e Bashkisë Peqin ushtrojnë aktivitet tregtim të karburanteve 10 subjekte, nga të cilët pajisur me liçensë 4 subjekte të cilat kanë likujduar detyrimet fiskale, ndërsa **6 subjekte** ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me Autorizim/Licenca për shitje karburanti, duke mos paguar vlerën për tarifën e autorizimit prej 1,000,000 lekë/subjekti ose **6,000,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë Peqin** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 26-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, bashkia Peqin, të marrë të gjitha masat për bllokimin e aktivitet të subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregti karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë ushtrim aktivitet, për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit prej **6,000,000 lekë nda 6 subjekteve, konkretisht:**

- vlera **1,000,000 lekë**, nga subjekti “B” me përfaqësues z. D.B;
- vlera **1,000,000 lekë**, nga subjekti D-O” me administrator D.Xh;
- vlera **1,000,000 lekë**, nga subjekti “J. P” me administrator G. P;
- vlera **1,000,000 lekë**, nga subjekti “B” m administrator B.B;
- vlera **1,000,000 lekë**, nga subjekti “D” me administrator N.D;
- vlera **1,000,000 lekë**, nga subjekti “B” me administrator B.B.

Menjëherë

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e debitorëve nga taksat e tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2023, rezulton se:

Gjendja e debitorëve më 31.12.2023 është në vlerën **36,951,278 lekë për 5918 subjekte/abonentë**, vlerë e cila është e kontabilizuar në llog 468, nga e cila: për 238 subjekte

fizik/juridik me vlerë 14,372,078 lekë dhe 5688 abonentë familjarë për vlerën 22,579,200 lekë (sipas listave që disponon Drejtoria e taksave).

Në krahasim me fundin e vitit 2022, kjo vlerë ka pësuar rritje për vlerën 6,056,720 lekë për 360 subjekte/abonentë, nga e cila: për 8 subjekte fizik/juridik me vlerë 2,781,520 lekë dhe 368 abonentë familjarë për vlerën 3,275,200 lekë

Nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është ndjekur procedurë për mbledhjes me forcë të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 26-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Peqin, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën **36,951,278 lekë**.

Brenda datës 30.12.2024

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi fondin pyjor, rezulton se nga Bashkia Peqin të jenë lidhur 9 kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, të cilat kanë si objekt aktiviteti “agropylltari”. Nga vlera e detyrimit të kontratës, rezulton se për vitin 2023 nuk kanë likuajduar detyrimet kontraktuale **6 subjekte në vlerën prej 538,208 lekë**, vlerë e cila nuk është e kontabilizuar, duke mos përmbushur kështu kushtet e kontratës mbi pagesën, të cilat përbëjnë shkak për zgjidhjen e marrëdhënies kontraktuale (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin Juridik të lidhjes së kontratave të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimit **prej 538,208 lekë ndaje 6 subjekteve**. Në rast mos likuajdimi sipas afateve të vijojejnë me procedurat për zgjidhjen e kontratave përkatëse për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit, lihet në kompetencë të **Kryetarit të Bashkisë Peqin**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT